



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

**RAPORT I VLERËSIMIT TË JASHTËM**

**Programi i Studimit me Karakter Profesional në: “Turizem”**

**Universiteti Europian i Tiranës**

**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:**

**Prof. Dr. Klodiana GORICA**

**Prof. Asoc. Dr. Ermelidna KORDHA**

**Tetor / 2021**

**TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT****ME KARAKTER PROFESIONAL NË “TURIZËM”**


1	IAL aplikues:	Universiteti Europian i Tiranës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut
3	Emërtimi i programit të studimit:	Program me karakter profesional në: “Turizëm”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër Nr. 567, datë 12.09.2018
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Program me karakter profesional
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 5
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	9 PAE / 1 PAK
18	Numri i studentëve:	30 studentë *
19	Komente / të tjera:	-

\* Numri i studentëve është dhënë për tre vite akademike

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423


Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al



## PËRMBLEDHJE E TE DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti Europian i Tiranës përbën një institucion të rëndësishëm të arsimit të lartë shqiptar me rëndësi strategjike dhe rol të fortë mbështetës në politikën kombëtare të arsimit të lartë në Shqipëri. Programi i studimit “Diplomë Profesionale në: Turizëm” është licensuar në bazë të Urdhërit të MASR Nr. 567, datë 12.09.2018, dhe hartuar në përputhje me Misionin e UET të shprehur në Statutin e UET, për t’ju dhënë studentëve një edukim cilësor, me qëllim që të ndërtojë një shoqëri të së ardhmes, bazuar në dije. Programi i studimit ka të përcaktuar në Rregulloren e tij, objektivat e tij, dhe ofron njohuri në përputhje me Misionin dhe Objektivat e institucionit. Gjithashtu ky program është në përshtatje dhe në zbatim të Strategjisë për Zhvillim të Institucionit, ku UET synon të bëhet një lider në sistemin universitar shqiptar, duke realizuar me cilësi të lartë e standarte ndërkombëtare, misionin e tij në fushën e arsimit të lartë. Sikurse citohet edhe në dokumentin e Strategjia Kombëtare për Zhvillimin e Turizmit, 2019-2023: “Tanimë, nuk ka asnjë dyshim që turizmi po hyn në kryefjalën e zhvillimit ekonomik, social dhe kombëtar të vendit tonë. Të dhënat vit pas viti dëshmojnë ngjitjen e turizmit si një ndër sektorët që sjellin më shumë të ardhura në buxhetin e shtetit, buxhetin sipërmarrës dhe atë familjar, me një kontribut direkt në PBB prej 8.5% dhe një vlerë të shtuar indirekte prej 26.2%. Turizmi është po ashtu edhe sektori që ka potencialin më të lartë të punësimit, nga ku 93 mijë kanë qenë të punësuarit direkt dhe mbi 291 mijë ishin të punësuarit total në këtë sektor përgjatë 2017-ës. Kjo do të thotë se vlera e shtuar e këtij sektori ka një rëndësi ekonomike dhe strategjike për vendin, pasi për çdo 1 lek të investuar, krijohen 3 lekë vlerë e shtuar dhe për çdo 1 të punësuar në këtë sektor, hapen 3 vende të reja pune. Keto të dhëna, por jo vetëm, tregojnë nivelin e lartë të pritshmërisë së qeverisë shqiptare, dhe rrjedhimisht edhe të institucioneve të larta akademike që ofrojnë programe të tilla në mbështetje të përbushjes së ketyre objektivave, së pritshmërisë për vendet e punës, prirjet për zhvillimin e këtij sektori do të jenë relativisht të larta, që në fakt mundesojnë edhe një qasje edhe më proaktive të UET ndaj këtij programi studimi. Në këtë kuader dhe vijimesi vjen edhe ofrimi i diplomës profesionale me synimin e përbushjes tashme të të gjithë nevojave që tregu paraqet, si dhe nevojës së zgjerimit cilësor. Kështu, parimi i përgjithshëm që UET ndjek për një rritje cilësore ka rezultuar edhe me prodhime të radhës cilësore, me outpute të sigurta dhe të qëndrueshme ndaj kohës. Pra, teksa rritet në nivele kombëtare dhe ndërkombëtare, hapja e një programi të tillë vjen natyrisht në përgjigje të rritjes së tregut shqiptar dhe diversifikimit të nevojës për ofrime të diplomave profesionale në sektoret me të rëndësishme që ofrojnë punë masive dhe cilësore për brezin e ri, një kohezgjatje dhe siguri në punë, si dhe mundësi marrëveshjeje sa më të mëdha që i japin sigurisht stabilitet institucionit të arsimit të lartë UET.



## **PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

Procesi i vlerësimit të jashtëm paraqitet si një proces që ka ndjekur hapat rigorozë të cilat janë në zbatim të ligjit për arsimin e lartë dhe gjithë bazës ligjore për vepriminë e Agjencisë për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL). Procedura përfshiu fillimisht kontaktin me ekspertët dhe grupin e Vlerësimit të Jashtëm GVJ, të cilët janë trainuar paraprakisht me standartet e cilësisë dhe kriteret, si edhe me përdorimin e sistemit elektronik në pjesën e panelit të ekspertit. Është vendosur që në fillim një komunikim shumë i mirë në grupin e punës midis ekspertëve dhe menaxherit teknik nga ASCAL, gjë që ka vazhduar gjatë gjithë procesit dhe ka qenë e rëndësishme për ecurinë e mirë të tij. Pas njohjes dhe shfrytëzimit të dokumentacionit të dorëzuar nga institucioni për diplomën përkatëse, u ndërtua një agjendë për vizitën në institucion dhe u organizua puna për realizimin e saj. Agjenda u zbatua duke ndikuar pozitivisht në mbledhjen dhe grumbullimin e informacioneve të mëtejshme të cilat ndikuan në një vlerësim bazuar mbi informacion sa më të detajuar. Grupi i vlerësimit të jashtëm ka në përbërje Prof. Dr. Klodiana Gorica dhe Prof. Asoc. Dr. Ermelinda Kordha. Gjatë të gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm ky grup pune u asistua dhe nga menaxherja teknike e ASCAL, Znj. Majlinda Demirneli. Pas vizitës në terren u realizua raporti përfundimtar nga ekspertët e jashtëm dhe ky u dorëzua për rishikim nga ASCAL dhe për njohjen me të të GVB.

Universiteti Europian i Tiranës është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 27.09.2021, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 19/82 Prot, datë 27.09.2021. Universiteti Europian i Tiranës përcjell në sistemin AMS me datë 29 Shtator me anë të shkresës me Nr. 78/57 Prot, datë 28.09.2021, “Kthim përgjigje mbi draft raportin e vlerësimit të jashtëm”, ku konfirmon dakortësinë me vlerësimin e kryer nga ekspertët e jashtëm. Në këtë mënyrë Draft Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.



**Vlerësimi i Programit të Studimit me karakter profesional “Diplomë Profesionale: Turizëm”**

**I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL**

**Standardi I.1**

**Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi me karakter profesional në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij dhe në përputhje me nevojat e kërkesat e tregut të punës.**

**Kriteret**

**Vlerësimi**

**Kriteri 1.** Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.

Programi i studimit “Diplomë Profesionale: Turizëm”, që ofrohet nga Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut, Fakulteti i Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit. Ky program, është hapur me Urdhërin e Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Nr. 567, Datë 09/12/2018; Vendimin e Fakultetit të Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit, Nr. 34 datë 15/05/2018 (ndryshuar me Vendimin e Fakultetit të Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit, Nr.55, datë 30/07/2018); Vendimin e Senatit Akademik të UET, Nr. 6, datë 14/06/2018, (ndryshuar me Vendimin e Senatit Akademik të UET, Nr.06/1, datë 31/07/2018); si edhe Vendimin e Bordit të Administrimit të UET, Nr. 47, datë 21/06/2018.

Veprimtaria akademike në programin e studimit me karakter profesional në “Turizëm”, fillon në vitin akademik 2018-2019. Dokumentat strategjike të vena në dispozicion dokumentojnë qartë se programi aktual i studimit është hartuar në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, por sigurisht të bazuar edhe në specifikat që ka rezultuar studimi i tregut. Plani strategjik për zhvillimin e programit të studimit me karakter profesional në “Turizëm” i hartuar nga departamenti i menaxhimit dhe i marketingut tregon një qasje proaktive me të gjitha dokumentat strategjike në nivel universiteti.

*Urdhër Nr. 567, datë 09/12/2018, për hapjen e Programit të Studimit me Karakter Profesional në “Turizëm”, në Universitetin Europian të Tiranës (Ref.Nr.54)*

*Vendimin Nr. 34 datë 15/05/2018 i Fakultetit të Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit (Ref. Nr. 54)*

*Vendimin Nr. 55. datë 30/07/2018 i Fakultetit të Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit (Ref. Nr. 54)*

*Vendimin Nr. 6 datë 14/06/2018 i Senatit Akademik (Ref. Nr.54)*

	<p><i>Vendimin Nr. 06/1 datë 31/07/2018 i Senatit Akademik (Ref. Nr.54)</i></p> <p><i>Vendimin Nr.47 datë 21/06/2018 i Bordit të Administrimit (Ref. Nr.54)</i></p> <p><i>Statuti i Universitetit European të Tiranës (Ref. Nr.2)</i></p> <p><i>Rregullore Mësimore E Programit të Studimit DP- Turizëm, 3.3 Objektivat e Programit te studimit (Ref. Nr.7.1)</i></p> <p><i>Strategjia e Kërkimit Shkencor UET 2017-2020 (Ref.Nr.3)</i></p> <p><i>Plani Strategjik 2015-2020 (Ref. Nr.4)</i></p> <p><i>Rregullore e Universitetit European të Tiranës (Ref. Nr.5)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Statuti dhe rregullorja e institucionit duhet të përcaktojnë qartë drejtimit prioritare akademike të tij dhe të demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.</p>	<p>Mbeshtetja ne ndertimin dhe zhvillimin e ketij programi studimi eshte totalisht ne mbeshtetje te dokumentacionit strategjik te Ministrise se Arsimit Rinise dhe Sporteve, linjes se UET dhe ne nivel universiteti dhe fakulteti, te shprehura keto edhe ne dokumentacionet baze strategjike. Programi i studimit, zhvillohet me kohë të plotë, i organizuar në module ose lëndë, dhe të shprehura në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit të Krediteve (ECTS), në frymën e Kartës së Bolonjës. Statuti, Rregullorja e Institucionit, si edhe Urdhri i Ministrit të Arsimit Sportit dhe Rinisë, përcaktojnë drejtimit prioritare akademike të programit dhe demonstrojnë se ai është hartuar dhe ofrohet në përputhje dhe në zbatim të tyre. Gjithashtu, edhe Objektivat e Programit të Studimit, të shprehura në Rregulloren e tij, demonstrojnë qartë se programi i studimit “Diplome Profesionale në: Turizëm”, është hartuar dhe ofrohet në përputhje dhe në zbatim të drejtimeve prioritare akademike të Institucionit.</p> <p><i>Statuti i Universitetit European të Tiranës (Ref. Nr.2)</i></p> <p><i>Rregullore Mësimore E Programit të Studimit DP- Turizëm, 3.3</i></p> <p><i>Urdhër Nr. 567, datë 09/12/2018, për hapjen e Programit të Studimit me Karakter Profesional në “Turizëm”, në Universitetin European të Tiranës (Ref.Nr.54)</i></p> <p><i>Vendimin Nr. 34 datë 15/05/2018 i Fakultetit te Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit (Ref. Nr.54)</i></p> <p><i>Rregullore e Universitetit European të Tiranës (Ref. Nr.5)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimeve ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit, si dhe fushën akademike të njësisë kryesore/kolegjit profesional dhe atë të njësisë bazë përgjegjëse për programin</p>	<p>Ky program studimi ofrohet nga Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut, pjesë e Fakultetit të Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimi. Në Rregulloren e UET, si edhe në Rregulloren e Programit të Studimit, qartësisht tregohet që programi ofrohet në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit. Objektivi kryesor i këtij programi studimi është</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>e studimit.</p>	<p>formimi i specialistëve të mirëfilltë në fushat praktike të turizmit. Ky program është me natyrë aplikative dhe ofron formim kryesisht praktik, për arritjen e objektivave profesionale në fushën e turizmit dhe industrisë së mikpritjes, me synimin e pajisjes së studentit me aftësi dhe njohuri bazë në këto fusha, për të garantuar një karrierë të suksesshme profesionale. Ky program studimi inkurajon tek studenti mendimin kritik dhe kreativ, nëpërmjet një modeli mësimi të mbështetur në praktikat më të mira vendase dhe të huaja.</p> <p><i>Rregullore e Universitetit European të Tiranës (Ref. Nr.5)</i></p> <p><i>Urdhëri Nr. 527, datë 04.09.2018 për Riorganizimin e Njesisë Kryesore Fakulteti Ekonomik dhe i Teknologjisë së Informacionit në Fakulteti i Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit, në Universitetin European të Tiranës (Ref. Nr.54)</i></p> <p><i>Urdhëri Nr. 527, datë 04.09.2018 për Riorganizimin e Njesisë Kryesore Fakulteti Ekonomik dhe i Teknologjisë së Informacionit në Fakulteti i Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit, në Universitetin European të Tiranës (Ref. Nr.54)</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Propozimi, hartimi dhe realizimi i programit të studimit me karakter profesional mbështetet në studime të mirëfillta mbi tregun lokal e kombëtar të punësimit për këto programe.</p> <p><b>Kriteri 5.</b> Gjatë realizimit të programit të studimit, nga pranimi në diplomim dhe pas daljes së studentëve në punë, zhvillohen studime periodike mbi tregun e punës, ndryshimet përkatëse dhe punësimin e studentëve.</p>	<p>Nder tri vite qe ky program eshte i hapur dhe ofron diploma per ata qe kerkojne dije dhe njohuri profesionale, ky program studimi nuk ka patur ndryshime te kurikules ne vite dhe ecuria e programit te studimeve ka qene e njejte dhe standarte. Sigurisht qe ka patur kontakte me biznesin per permiresimin e kurrikules te programit, ne perputhje ne nevojat e biznesit. Keshtu disa takime jane zhvilluar me operatoret turistike konkretisht ne mjediset e brendshme te UET. Nga takimi ne institucion si me stafin ashtu edhe me drejtuesit e departamentit dhe te fakultetit, vihet re nje perkushtim serioz ndaj pergjegjesise qe ata mbartin per te patur nje qasje sa me te afert dhe te ngushte me biznesin dhe studentet. Keshtu nga ata vleresohen si pika te forta diskutimet mes studenteve te ketij profili me operatore te fuqishem dhe te rendesishem ne tregun shqiptar te turizmit si Enver Mehmeti nga VAS Tour, apo Zak Topuzi nga Mondial Hotel, etj. Dokumenta strategjike si studimi i tregut te punes por edhe plani strategjik i departamentit ne mbeshtetje te kesaj diplome, tregojne se:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• eshte zhvilluar nje studim tregu nga departamenti;</li> <li>• jane zhvilluar takime individuale dhe tryeza te rumbullaketa me operatore dhe individe te rendesishem te turizmit shqiptar. Keto takime kane</li> </ul>

perditesuar edhe studentet per dijet dhe informacionet qe kerkon tregu;

Organizimi i kahershem i panairove me biznesin, kthimi i kesaj ngjarjeje ne nje event te pervitshem dhe stabel, vendosja e marevshjeve te bashkepunimit ne nivele kombetare dhe nderkombetare, kthimi i ketyre marevshjeve ne projekte konkrete gjithperfshireve te shoqeruara me ngritjen e kapaciteteve kerkimore si qendra apo institucione kerkimore brenda UET, e kane kthyer kete intitucion ne nje qender te prodhimit cilesor te dijeve, kapaciteteve, njohurive dhe aftesimeve te se ardhmes.

Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut, qe mbulon ketë program, vazhdimisht nxjerr në pah nevojën e tregut për formimin në nivelin operacional, të specialistëve për sipërmarrjet turistike, specialistëve në aplikimin e projekteve të lidhura me turizmin, specialistëve të sektorit publik dhe privat (në këtë fushë) etj, duke marrë në konsideratë pikërisht faktin e përmendur mesipër, që turizmi është shndërruar në një nga sektoret prioritarë për zhvillimin ekonomik dhe social të vendit tonë. Këtë zhvillim Departamenti e reflekton në punën dhe në qasjen e tij kundrejt ecurisë së programit dhe përgatitjes së studentëve që e ndjekin atë. Programi u ofron studentëve njohuri të specializuara në fushën e turizmit, duke u siguruar atyre një mundësi për një edukim cilësor, përmes leksioneve dhe seminareve, eseve dhe detyrave të kursit, praktikës profesionale, projektit/esesë kerkimore në përfundim të studimit, si edhe shumë elementëve të tjerë formues. Programi është në përputhje të plotë me kërkesat për zhvillimin ekonomik lokal dhe kombëtar, dhe reflekton, kërkesat dhe specifikat e tregut të punës në sferën e turizmit, si edhe zhvillimet në tregun e punës vendas dhe atë rajonal.

*2.4 Analiza vjetore, Puna shkencore vjetore e departamentit*

*2.3 Analiza e departamentit final tetor 2019*

*2.1. Plan aktivite Manaxhimi 2020 2021*

*3. Komunikimet per ofertat e punesimit*

*17. Studim tregu*


*Bordi i Tregut Të Punës 2017-2018, Departamenti Menaxhim Dhe Marketing (Ref. Nr.16.1)*

*Plan-Projekt Alumni (Ref. Nr.12.2)*

*UET Alumni Business III/2019 (Ref. Nr.12.3)*



	<i>Panairi i Punës 2019, "Dita e Biznesit në UET" (Ref. Nr.12.1)</i>
<p><b>Kriteri 6.</b> Studimet paraprake dhe periodike të tregut të punës për programet me karakter profesional duhet të përfshijnë të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>Ky program është modeluar me synim rritjen e mundësive për zhvillim dhe punësim të studentëve, të niveleve mesatare të formimit, të karakterizuar nga dëshira e investimit në drejtim të njohurive profesionale cilësore në përputhje me nevojat e tregut në vend. Ky program studimi, që në fillimet e tij është mbështetur në trajtimin e vëmendshëm të kompetencave që kërkon tregu shqiptar i punës dhe strukturës profesionale të vendeve të punës në operatorët e turizmit. Praktikisht, në ndërtimin e kurrikulës së këtij programi studimi janë adresuar kërkesat dhe veçoritë e tregut të punës në vend, lidhur me nivelin dhe llojin e njohurive që një specialist, apo profesionist i fushës së turizmit, duhet të zotërojë, duke synuar specializimin në sektorin e shërbimeve specifike. Pavaresisht se nuk janë bere ndryshime ne planin dhe strukturen mesimore, per shkak te nevojës per ta testuar ne treg paraprakisht, nga takimi ne terren me drejtuesin e departamentit te marketing manaxhimit rezulton se stafi i departamentit eshte ne pritje te rekomandimeve dhe akreditimit te ketij program studimi me qellim qe me tej te beje te gjitha reflektimet e nevojshme te rekomanduara por edhe te vena re nga ecuria ne keto tre vite te ketij program studimi. Gjithashtu, UET, nëpërmjet Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit mbështet në mënyrë institucionale studentët gjatë gjithë kohëzgjatjes së studimeve duke shpërndarë informacione mbi mundësitë e punësimit. Gjithashtu, kjo zyrë, së bashku me Shoqatën "Alumni UET", ndjekin studentët pas diplomimit.</p> <p>Pavaresisht kesaj i sugjerohet departamentit se per shkak edhe te Panemise Covid 19, edhe te ndryshimit te menyres se berjes bisnes, te rëndesise se perfshirjes se teknologjise dhe ringritjes qe po peson edhe turizmi shqiptar, eshte e nevojshme qe te reflektohet edhe ne kerkime te metejshme qe UET duhet te ndermarre jo vetem per t'i paraprire permiresimit te kurrikulles, por edhe nevojës per nje edukim ndryshe mbarekombetar ne turizmin shqiptar, sikurse UET ka marre edhe persiper te mbarte rolin e nje univrsiteti lider ne arsimin e larte privat. Kjo gje, ky objektivi e rrit pergjegjeshmerine dhe detyrimin ndaj te rinjve shqiptare, per te bashkeofruar kurrikula sa me cilesore ne turizem, qofte profesionale apo bachelor, per te bashkerenduar qofte edhe me universitetet e tjera qe ofrojne programe te tilla apo te</p>




	<p>ngjashme, per te rritur numrin e bashkepunimeve me insitucionet kryesore private qe terheqin kete brez te diplomuarisht por edhe "porosisin" kerkesen e tyre per njohuri dhe dije tek universitetet perkatese. Turizmi shqiptar ka nevojte te ringrihet, arsimi larte duhet te mbeshtese ne menyre cilesore kete process duke mirebere dhe kryer objektivin e vet.</p> <p><i>Broshura e Dokumenteve, në Zbatim të Statutit dhe të Rregullores së UET-it, E.VII. Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit (Ref. Nr.12)</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

### Standardi I.2

**Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit dhe me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, dhe në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.**

Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p> <p><b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave të procesit mësimor, formimin teorik e praktik të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie afatgjata e të qëndrueshme bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, me punëdhënës vendës, aktorë të biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>I ofruar tashme prej tre vitesh te veshtira edhe per shkaqe natyrore si termeti dhe covid, UET ka bere perpjekjen e vet per t'a ofruar ne menyre cilesore, per te vezhguar me kujdes problematikat dhe nevojat e permiresimit te metejshem teksa eshte i ndergjegjshem dhe i sigurte per ekzistencen e problematikave dhe veshtiresive qe mund te paraqiten prej faktoreve te ndryshem, por me qartesine dhe sigurine e permiresimeve te metejshme dhe ecjes se sigurte ne rrugen e standarteve cilesore te mesimdhenies. Përtej këndvështrimit akademik, ky program synon te kontribuojë në ndërgjegjësimin dhe rritjen e përgjegjshmërisë së biznesit shqiptar dhe shoqërisë shqiptare, në rritjen e përpjekjeve për zhvillimin e kapitalit human në këndvështrimin e "ofertës" duke nxitur bashkëpunimin, harmonizimin dhe ndërveprimin ndërmjet të gjitha grupeve të interesit, si faktorë themelorë suksesti të çdo sipërmarrje, dhe njëherazi, me ndikim të drejtëpërdrejtë në zhvillimin ekonomik e social të vendit. Vleresimi i ketij program eshte mjaft kompleks, gje e cila ne rradhe te pare do te thote se nga njera ane vihet re dhe eshte e prekshme nje perkushtim maksimal dhe gjithepershires i te</p>

	<p>gjithe stafit te UET per te mbeshtetur programin qe po akreditohet, dhe nga ana tjeter vihet re mungesa e experiences, periodha e COVID 19, kane ndikuar ndjeshem ne pamundesine e departamentit per te dhene maksimumin per kete program studimi. Keshtu psh:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Ulja e numrit te studenteve ne vitin e trete te studimit dhe ofrimit te ketij program nga 1- apo 12 ne 5 e ka pamundesuar jo vetem promovimin e programit, apo marrjen e nje feedback nga studentet per permiresim cilesor te programit te studimit;</li> <li>2. Marredheniet me te prekshme me biznesin dhe mundesimi i realizimit te praktikave apo aktiviteve te tjera online per te rritur jo vetem dhenien e njohurive konkretisht dhe ne praktike tek studentet, por edhe rritjen e produktit te dijeve ne terren, kane pamundesuar arritjen e disa objektivave;</li> </ol>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Edhe ne vizionin e tij, Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut e mbështet planin strategjik të zhvillimit të programit të studimit me karakter profesional në “Turizëm” në përcaktimin e qartë të objektivave strategjike dhe prioriteteve të Universitetit, Fakultetit dhe Departamentit, për të përbushur misionin e tij, nëpërmjet rritjes të ofertës akademike në drejtim të larmishmërisë së profesionave në tregun e punës, duke kontribuar në rritjen e mundësive për zhvillim dhe punësim të studentëve. Ne kete menyre departamenti ofron qarte nundësitë e punësimit dhe të kualifikimit profesional te studenteve. Marrëveshjet e bashkëpunimit të njësisë përgjegjëse për programin e studimit, mund të shihen në tre aspekte kryesore:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- bashkëpunime të vet njësisë;</li> <li>- bashkëpunime të Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit;</li> <li>- bashkëpunime te Zyrës së Projekteve dhe Partneriteteve (zyra me të cilat departamenti ka marrëdhënie të ngushta bashkëpunimi);</li> </ul> <p><i>Raporti ne lidhje me Mobilitetet i Zyrës së Projekteve dhe Partneriteteve, Marrëveshje aktive Erasmus+ KA107 të zbatuara gjatë 2019-2020 (Ref.Nr.43.2)</i></p> <p><i>Lista e Marrëveshjeve të Bashkëpunimit midis UET dhe institucioneve të tjera (Ref.Nr.34.)</i></p> <p><i>Programi 250+, Programi 500+ (Ref. Nr.17.5)</i></p> <p><i>Lista e subjekteve dhe institucioneve bashkëpunuese. (Tabela 5) ,</i></p>



	<p><i>pjesë e anekseve të Raportit(Ref.Nr.32)</i></p> <p><i>Broshura e Dokumenteve, në Zbatim të Statutit dhe të Rregullores së UET-it, B.I Mbi praktikën profesionale (Ref.Nr.32.1)</i></p> <p><i>Broshura e Dokumenteve, në Zbatim të Statutit dhe të Rregullores së UET-it, E.VII. Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit (Ref. Nr.12)</i></p> <p><i>Broshura e Dokumenteve, në Zbatim të Statutit dhe të Rregullores së UET-it, C.IV. Parimet e organizimit të Zyrës së Projekteve dhe Partneriteteve (Ref.Nr.43.1)</i></p> <p><i>Raporti ne lidhje me Mobilitetet i Zyrës së Projekteve dhe Partneriteteve, Marrëveshje aktive Erasmus+ KA107 të zbatuara gjatë 2019-2020 (Ref.Nr.43.2)</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.</p> <p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni ndërmerr iniciativa specifike në mbështetje të sipërmarrjes dhe punësimit të studentëve.</p>	<p>UET ka ndertuar nje sistem te tere te manaxhimit te marredhenieve me bizneset, sipermarrjes dhe perfshirjes se studenteve ne kete qarkullim proaktiv jo vetem per UET por edhe per biznesin dhe ekonomine shqiptare. Keshtu, nëpërmjet Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit mbështet në mënyrë institucionale studentët, gjatë gjithë kohëzgjatjes së studimeve, duke ofruar konsulencë për aplikime dhe duke shpërndarë informacione mbi mundësitë e punësimit. Kjo zyrë, së bashku me Shoqatën “Alumni UET”, ndjekin studentët pas diplomimit duke mbledhur, përpunuar dhe mbajtur të dhëna mbi punësimin e ish-studentëve të programit të studimit, si edhe zhvillimet dhe ndryshimet në tregun e punës, dhe ua vendos ato në dispozicion studentëve. Gjithashtu, edhe nëpërmjet kontakteve prej marrëveshjeve dhe bashkëpunimeve të krijuara me kompani dhe institucione në treg, institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe i mbështet ata në mënyrë institucionale për t’i orientuar në tregun e punës nëpërmjet: UET Open Days, Bizneseve dhe Ekspertëve të Ftuar në Auditor, Takimeve me Alumni UET, Bizneseve dhe Ekspertëve në Aktivitete Periodike, Takimeve të Bordit të Tregut të Punës, etj. Njihet dhe vleresohet tashme roli proaktiv i UET ndaj sipërmarrjeve shqiptare, kerkimit shkencor dhe zhvillimeve me tregun e punes.</p> <p><i>Broshura e Dokumenteve, në Zbatim të Statutit dhe të Rregullores së UET-it, B.I Mbi praktikën profesionale (Ref.Nr.32.1)</i></p> <p><i>Broshura e Dokumenteve, në Zbatim të Statutit dhe të Rregullores së UET-it, E.VII. Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit (Ref. Nr.12)</i></p> <p><i>Plan-Projekt Alumni (Ref. Nr.12.2)</i></p> <p><i>UET Alumni Business III/2019 (Ref. Nr.12.3)</i></p>

	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### Standardi I.3

**Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënljore kombëtare në fuqi dhe Kuadrin Evropian e Shqiptar të Kualifikimeve për këto programe studimi.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Programet e studimeve janë të organizuara në lëndë/module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Struktura dhe përmbatja e programit me karakter profesional në “Turizëm”, është në përputhje me ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë”, si dhe akteve nënljore që rrjedhin prej tij. Ky program është i organizuar mbi bazën e Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Programi i studimit me karakter profesional është me kohë të plotë, me afat dy vjeçar dhe ka në total 120 kredite, në përputhje me pikën 1, nenin 72 të Ligjit nr. 80/2015. Ngarkesa është ndarë në mënyrë të barabartë, 60 kredite për secilin vit akademik. Procesi mësimor në të dy semestrat është organizuar në leksione, seminare, praktikë profesionale, punim i Diplomës (Provimi formimi/Projekt profesional). Jepen kreditet korresponduese për çdo lëndë, për praktikën dhe për diplomën (Provimi formimi/Projekt profesional). Ngarkesa totale në auditor është:</p> <p>Viti I 563 orë; Viti II 632 orë;</p> <p><b>Gjithësej 1195 orë mësimore në auditor;</b></p> <p>Praktika profesionale e studentëve organizohet, ndiqet dhe mbikëqyret nga Drejtuesi i Departamentit në bashkëpunim me Zyrën e Karrierës. Si veprimtari formuese e programit, ajo është e detyrueshme dhe kusht i domosdoshëm për të përfunduar studimet. Studenti i cili nuk shlyen praktikën profesionale nuk ka të drejtë të mbrojë diplomën.</p> <p><i>Diplomë Profesionale Turizëm, Kurrikula (Ref.Nr.14)</i></p> <p><i>Rregullore Mësimore E Programit të Studimit DP- Turizëm , 3. Programi i Studimit, dhe Pika 4. Kreditet Praktika Profesionale (Ref.Nr.7)</i></p> <p><i>Plani mësimor i Programit të studimit me karakter profesional në Turizëm (Ref.Nr.14.1)</i></p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

**Kriteri 2.** Programet e studimeve me karakter profesional synojnë përfundimin e njohurive gjithë përfshirëse të specializuara teorike dhe praktike brenda një fushe punësimit në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.

Në funksion të arritjes të objektivave strategjike, Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut vlerëson si parësore aftësimin profesional të studentëve në programin e studimit me karakter profesional në "Turizëm". DPT nëpërmjet programit të studimit, synon të pajisë studentët me njohuri teorike dhe praktike që të zhvillojnë një perspektivë të integruar dhe harmonizuar mbi kuptimin, përmbajtjen dhe zhvillimin e industrisë së turizmit dhe të mikpritjes. Programi i studimit Diplomë Profesionale në Turizëm synon ta pajisë studentin me këto aftësi kyçe:

- njohuri rreth koncepteve kryesore të turizmit dhe mikpritjes;
- njohuri rreth impaktet ekonomike, sociale dhe mjedisore të turizmit, aktorët dhe komponentët e ndryshëm të turizmit, rëndësinë, funksionet e tyre për të punuar së bashku në krijimin e një eksperiencë pozitive udhëtimi;
- njohuri rreth trashëgimisë natyrore dhe kulturore;
- si të menaxhojnë destinacionet për një zhvillim turizmi të suksesshëm dhe të qëndrueshëm;
- të krijojnë dhe zhvillojnë një menu, të kontrollojnë operacionet e përditshme, të jenë të aftë të shërbejnë dhe mbikqyrin në restorant dhe hotel.

*Rregullore Mësimore E Programit të Studimit DP- Turizëm, 3.3 Objektivat e Programit të studimit (Ref. Nr.7.1)*

*Diplomë Profesionale Turizëm, Kurrikula (Ref.Nr.14)*

**Kriteri 3.** Programet e studimit me karakter profesional synojnë pajisjen e studentëve me një sërë aftësish njohëse dhe praktike gjithëpërfshirëse që nevojiten për të zgjidhur në mënyrë krijuese probleme të karakterit profesional praktik.

Programi i studimit Diplomë profesionale në Turizëm" i hap mundësi studentëve të punojnë në sektorë publike dhe jo-publikë, si psh: specialistë të turizmit në administratën lokale, menaxherë të shërbimeve hoteliere dhe restorantore, specialistë agjensish turistike, tour operatorë dhe specialistë të departamenteve të vecanta dhe zyrave të zhvillimit të turizmit, etj. Ky program synon ta pajisë studentin me disa aftësi kyçe, përkatësisht njohuri rreth koncepteve kryesore të turizmit dhe mikpritjes; njohuri rreth impakteve ekonomike, sociale dhe mjedisore të turizmit, aktorët dhe komponentët e ndryshëm të turizmit, rëndësinë, funksionet e tyre për të punuar së bashku në krijimin e një eksperiencë pozitive udhëtimi; njohuri rreth trashëgimisë natyrore dhe kulturore; si të menaxhojnë destinacionet për një zhvillim turizmi të suksesshëm dhe të qëndrueshëm, të krijojnë dhe zhvillojnë një menu, të kontrollojnë operacionet e përditshme, të jenë të aftë të shërbejnë dhe mbikqyrin në restorant dhe hotel, etj. Pavaresisht

	<p>vitit te veshitire te Covid 19, studenteve ne menyre edhe online u jane kryer takime te shumta online jo vetem per te qene prane tyre dhe orintuar por edhe mundesuar praktiken profesionale, takimet me biznesin, etj, me qellimin e nje qasjeje dhe mbeshitetjeje te panderprere nga ana e stafit. Kjo gje u konfirmua edhe nga vizita ne institucion apo nga vete studentet.</p> <p><i>Rregullore Mësimore e Programit të Studimit DP- Turizëm, 3.3 Objektivat e Programit te studimit (Ref. Nr.7.1)</i></p> <p><i>Silabuset e Lëndëve të ofruara në vite (Ref.Nr.19)</i></p> <p><i>Rregullore Mësimore E Programit të Studimit DP- Turizëm, 3.3 Objektivat e Programit te studimit (Ref. Nr.7.1)</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit me karakter profesional synojnë zhvillimin e kompetencave për menaxhimin dhe mbikëqyrje në kuadrin e veprimtarive profesionale dhe orientimin e duhur në situata të ndryshme e të ndryshueshme.</p> <p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni/njësia kryesore/kolegji profesional dhe njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë të organizimit, strukturës akademike dhe numrit e shkallës së kualifikimit të stafit akademik.</p>	<p>Programi i studimit siguron një mundësi unike për studentët, për të fituar njohuri të specializuara profesionale në fushën e Turizmit, duke pajisur studentët me:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• njohuritë themelore teoriko-praktike,</li> <li>• praktikat bashkëkohore ndërkombëtare;</li> <li>• me përvojën shqiptare, në fushën e turizmit, përsa i përket funksionimit dhe menaxhimit të strukturave të specializuara në këtë fushë;</li> </ul> <p>Universiteti Europian i Tiranës përmbush kritret e përcaktuara nga pika 2, neni 20 e Ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në RSH”. Ky universitet është i përbërë nga 5 fakultete. Cdo Fakultet është i përbërë nga dy departamente dhe një qendër të kërkimit shkencor.</p> <p>Referuar dokumentit (23. <i>Te dhena tabelore per personelin akademik ne Njesine kryesore dhe njesine Baze</i>), Fakulteti i Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit në vitin akademik 2020-2021, ka në përbërje të tij <b>40 pedagogë gjithsej</b>, ndër të cilët, <b>30</b> janë staf akademik efektiv ( PAE), dhe <b>10</b> staf akademik me kontratë, (PAK).</p> <p>Sipas këtij dokumenti stafi akademik sipas departamenteve për vitin akademik 2020-2021 është:</p> <p><b><u>Departamenti i Ekonomisë dhe Financës:</u></b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 14 PAE, ndër të cilët 8 me tituj / grada;</li> <li>- 4 PAK, ndër të cilët 3 me tituj / grada;</li> </ul> <p><b><u>Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut:</u></b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 8 PAE, ndër të cilët 7 me tituj / grada;</li> </ul>

	<p>- 6 PAK, ndër të cilët 4 me tituj / grada;</p> <p><b><u>Qendra për Zhvillimin e Qëndrueshëm:</u></b></p> <p>- 8 PAE, ndër të cilët 3 me tituj / grada;</p> <p>- 0 PAK</p> <p>Ky program studimi manaxhohet nga Fakulteti i Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit dhe pëkatësisht njësia bazë Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut, në përputhje me kriterin e përcaktuar nga pika 4, neni 25 e ligjit nr. 80/2015, ku departamenti duhet të ketë në përbërje të tij të paktën 7 anëtarë, të punësuar me kohë të plotë, si personel akademik, nga të cilët të paktën tre me grada shkencore dhe tituj akademikë. Në përputhje me të dhënat e dokumentit (23. <i>Te dhëna tabelore per personelin akademik ne Njesine kryesore dhe njesine Baze</i>), Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut ka 8 pedagogë të brendshëm, nga të cilët 2 kanë titullin Prof.Dr, 2 titullin Prof.Asoc, 3 Doktor shkencash, dhe 1 Msc.</p> <p><i>Të dhëna tabelore për personelin akademik në Njesinë kryesore dhe njësinë Bazë, Tabela 1, pjesë e anekseve të Raportit (Ref.Nr.23)</i></p> <p><i>Broshura e Dokumenteve, në Zbatim të Statutit dhe të Rregullores së UET-it, G. Burimet Njerëzore (Ref. Nr.11)</i></p> <p><i>CV e stafit akademik të programit të studimit (Ref. Nr.20)</i></p> <p><i>Kontratë model e punës për personelin e brendshëm akademik (Ref. Nr.24.2)</i></p> <p><i>Kontratë model e punës për personelin e jashtëm akademik (Ref. Nr.24.1)</i></p> <p><i>Urdhëri Nr. 527, datë 04.09.2018 për Riorganizimin e Njesisë Kryesore Fakulteti Ekonomik dhe i Teknologjisë së Informacionit në Fakulteti i Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit, në Universitetin Europian të Tiranës (Ref. Nr.54)</i></p> <p><i>Të dhëna tabelore për personelin akademik në Njesinë kryesore dhe njësinë Bazë, Tabela 1, pjesë e anekseve të Raportit (Ref.Nr.23)</i></p> <p><i>Rregullore Mësimore E Programit të Studimit DP- Turizëm, 3.3 Objektivat e Programit te studimit (Ref. Nr.7.1)</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin profesional të studentëve, ku përfshihen dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që e karakterizojnë profilin profesional të programit.</p>	<p>Veprimtaria akademike në programin e studimit me karakter profesional në “Turizëm”, fillon në vitin akademik 2018-2019. Stafit por edhe drejtues të tij shprehen se keto tri vite që është ofruar kjo diplome do të shërbejnë si testim në treg mbi funksionalitetin, qasjen me tregun, dhe identifikimin e problematikave.</p> <p><i>Per te patur nje qasje mbeshetese per t'a bere ne menyre sa me cilesore kete program GVJ sugjeron qe jo vetem te shtohen me</i></p>






	<i>shume module dhe/ose lende qe lidhen me turizmin, por edhe me shume dije aftesi dhe njohuri te lidhura direkt me turizmin brenda lendeve te ketij programi.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

## II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL

<b>Standardi II.1</b>	
<b>Programet e studimeve me karakter profesional janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të këtij niveli dhe mundësitë e punësimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programet e studimit me karakter profesional, përmbajnë dhe japin informacionet e nevojshme për objektivat formues, rezultatet e pritshme të të nxënit, organizimin, strukturën, përmbajtjen, fushat e mundshme të punësimit apo të dhëna reale të punësimit të studentëve të diplomuar në këto programe.	Programi i studimit ka informacione të detajuara për objektivat dhe veprimtarinë formuese me qëllim punësimin e studentëve. Te gjithë dokumentacionet shoqeruese japin informacionet e nevojshme për objektivat formues, rezultatet e pritshme të të nxënit, organizimin, strukturën, përmbajtjen, fushat e mundshme të punësimit apo të dhëna reale të punësimit të studentëve të diplomuar në këtë program. Programi siguron një mundësi unike për studentët, për të fituar njohuri të specializuara profesionale në fushën e Turizmit, duke pajisur studentët me njohuritë themelore teoriko-praktike, me praktikat bashkëkohore ndërkombëtare dhe me përvojën shqiptare, në fushën e turizmit, përsa i përket funksionimit dhe menaxhimit të strukturave të specializuara në këtë fushë. Ai gjithashtu synon ta pajisë studentin me disa aftësi kyçe, përkatësisht njohuri rreth koncepteve kryesore të turizmit dhe mikpritjes; njohuri rreth impakteve ekonomike, sociale dhe mjedisore të turizmit, aktorët dhe komponentët e ndryshëm të turizmit, rëndësinë, funksionet e tyre për të punuar së bashku në krijimin e një eksperience pozitive udhëtimi; njohuri rreth trashëgimisë natyrore dhe kulturore; si



	<p>të menaxhojnë destinacionet për një zhvillim turizmi të suksesshëm dhe të qëndrueshëm; të krijojnë dhe zhvillojnë një menu, të kontrollojnë operacionet e përditshme, të jenë të aftë të shërbejnë dhe mbikqyrin në restorant dhe hotel, etj.</p> <p><i>Rregullore Mësimore E Programit të Studimit DP- Turizëm (Ref. nr. 7).</i></p> <p><i>Të dhëna për diplomimin dhe punësimin e studentëve, Tabeles 23 pjesë e anekseve të Raportit. (Ref. nr. 29).</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programet e studimit janë të organizuara në module/lëndë e aktivitete formuese, të vlerësuara me kredite, të ndara në vite e semestra e që janë në përputhje me përcaktimet vendëse e evropiane në fuqi.</p>	<p>Rregullorja mësimore e programit të studimit me karakter profesional mbështetet në Ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, VKM Nr. 41, dt.24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, në Statutin dhe Rregulloren e Universitetit Europian të Tiranës.</p> <p>Programi i studimit DP Turizëm është i organizuar në lëndë e aktivitete formuese, të vlerësuara me kredite, në përputhje me përcaktimet në fuqi. Programi është i organizuar me 120 ECTS, me kohëzgjatje 2 vite akademike, dhe i ndarë në katër semestra. Lëndët janë të organizuara sipas kategorive A-E. Shpërndarja e ngarkesës mësimore në semestra dhe vite, vlerësohet e balancuar dhe e përshtatshme, duke marrë në konsideratë si përcaktimet në fuqi, ashtu edhe natyrën e programit të studimit.</p> <p>Veprimtaria formuese e programit përbëhet nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Në kategorinë A LËNDË BAZË (19 ECTS, 15.8% e krediteve);</li> <li>• Në kategorinë B LËNDË KARAKTERIZUESE (58 ECTS, 48.3% e krediteve);</li> <li>• Në kategorinë C LËNDË NDËRDISIPLINORE /INTEGRUESE (24 ECTS, 20% e krediteve);</li> <li>• Në kategorinë D LËNDË PLOTËSUESE (14 ECTS, 11.6 % e krediteve);</li> <li>• Në kategorinë E - DETYRIME PËRMBYLLËSE (5 ECTS, 4.1 % e krediteve);</li> </ul> <p><i>Rregullore Mësimore E Programit të Studimit DP- Turizëm (Ref. nr. 7).</i></p> <p><i>Diplomë Profesionale Turizëm, Kurrikula (Ref.Nr.14)</i></p> <p><i>Silabuset e Lëndëve të ofruara në vite (Ref.Nr.19)</i></p>



	<p><i>Rregullore Mësimore E Programit të Studimit DP- Turizëm (Ref. nr. 7).</i></p> <p><i>Të dhëna për diplomimin dhe punësimin e studentëve, Tabeles 23 pjesë e anekseve te Raportit. (Ref. nr. 29).</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor, frekuentimin/ndjekjen e programit, vlerësimin e dijeve, aktivitete specifike etj.</p>	<p>Ne funksion të plotesimit të planit mesimor me të gjithë elementet perkates, përfshihen konkretisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• lëndët e programit të studimit,</li> <li>• ngarkesa e shprehur në ECTS,</li> <li>• kategoria përkatëse A-E (referuar VKM nr.41, datë 24.01.2018),</li> <li>• viti dhe semestri;</li> <li>• sikurse dhe ngarkesa për secilin komponent e shprehur në orë në auditor dhe orë punë e pavarur e studentit 1.</li> </ul> <p>Vlerësohet se shpërndarja e ngarkesës mësimore, ndarja në komponentë leksion/seminar sikurse dhe raporti midis ngarkesës në auditor dhe puna e pavarur, është e përshtatshme dhe konform përcaktimeve në fuqi.</p> <p><i>Plani mësimor i Programit të studimit me karakter profesional në Turizëm (Ref.Nr.14.1)</i></p> <p><i>Silabuset e Lëndëve të ofruara në vite (Ref.Nr.19)</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit përmbajnë sylabuset e detajuara për secilën lëndë, për praktikën, ushtrimet apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët e aktivitetet formuese të programit të studimit.</p>	<p>Syllabuset janë standarte, të unifikuara dhe me të gjitha informacionet që nga objektivat, literature, etj. Ajo cka sugjerohet në këtë rast, është përdorimi i një literature në gjuhën shqipe jo vetëm ato në ppt të përdorura nga lektori i lëndës por edhe nga autorë të tjerë. Në nivelet profesionale 2 vjeçare apo edhe në bachelor, studentët kanë me kollaj dhe thjeshtë përdorimin e një literature baze në Word në shqip, jo thjeshtë në ppt shqip, apo dhe literature të tjera por në shqip. Kjo me qëllimin e dhenies së saktë të koncepteve baze sipas edhe programit të studimit.</p> <p><i><u>GVJ sygjeron</u> që në lende apo module të formimit baze si statistike, matematike apo kontabilitet dhe informatike të përdoren literature me karakter aplikativ në turizëm. Psh statistika në turizëm, informatika në turizëm etj. Sugjerohet edhe me shumë ore praktike brenda vecanerisht lendeve të pakta të turizmit që ofron dhe mban ky program studimi.</i></p>



	<p><i>Diplomë Profesionale Turizëm, Kurrikula (Ref.Nr.14)</i></p> <p><i>VKM nr. 41, datë 24.01.2018 'Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë', i ndryshuar (Ref. nr. 53).</i></p> <p><i>Plani mësimor i Programit të studimit me karakter profesional në Turizëm (Ref.Nr.14.1)</i></p> <p><i>VKM nr. 879, datë 18.12.2019, Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr.41, datë 24.01.2018, të Keshillit të Ministrave, "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë" (Ref.Nr.53)</i></p> <p><i>Plani mësimor i Programit të studimit me karakter profesional në Turizëm (Ref.Nr.14.1)</i></p> <p><i>Silabuset e Lëndëve të ofruara në vite (Ref.Nr.19)</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Struktura dhe organizimi i programit të studimit është mjaftueshmërisht fleksibël për të mundësuar formimin e studentëve përgjatë programit dhe në përshtatje me punësimin.</p> <p><b>Kriteri 6.</b> Mësimi praktik dhe i elementeve të punës konkrete u është dhënë vendi dhe pesha e duhur në strukturë, vlerësim dhe rivlerësim.</p>	<p>Ne dokumentacionin shoqerues te ketij programi studimi theksohet se vemendja ka qene ne raportin e nje pune konkrete dhe mesim praktik dhe realizimit te tij ne menyre sa me harmonike. Keshtu, nje nder ceshtjet me te diskutuara lidhej me diskutimin midis grupit te eksperteve dhe stafit, se ne oret e seminarit zhvilloheshin te gjitha rastet konkrete ne industrine turizmin, pavaresisht se ndonjehere lendet nuk kishin lidhje me turizmin. Ne kete menyre, psh ne lendet e lidhura me statistiken apo matematiken dhe kontabilitetin, prania e ketyre lendeve ne nje kurrikul te tille te formimit profesional justifikohet se nje student i duhej te dinte disa njohuri bazike qe e mundesonin dhe e aftesonin ne praktike, dhe per kete stafi mesimdhene sugjeronte se mesimi ne seminare i kushtohet totalisht turizmit.</p> <p>Cituar edhe nga dekani dhe shefi i departamentit, i gjithe departamenti po pret akreditimin dhe perftrimin e sugjerimeve mbeshetese ne drejtim te permiresimit te cilesise se ketij programi, per te bere ndryshimet perkatese me tej, qe lidhen me raportin e oreve, me ristrukturimin dhe organizimin e programit te studimit me qellimin edhe te permiresimit te tij te ndjeshem por edhe te rritjes se konkurrueshmerise me IAL-te e tjera qe ofrojne diploma te ngjashme. Megjithate, edhe plani strategjik i programit të studimit rishikohet pas çdo periudhe tre vjeçare, bazuar në:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Planin strategjik të UET;</li> <li>- Konsultimet me Bordin e Tregut të Punës;</li> <li>- Aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;</li> </ul> <p><i>Plani mësimor i Programit të studimit me karakter profesional në</i></p>



	<p><i>Turizëm (Ref.Nr.14.1)</i></p> <p><i>Rregullore Mësimore E Programit të Studimit DP- Turizëm (Ref. nr. 7).</i></p> <p><i>Rregullore Mësimore E Programit të Studimit DP- Turizëm, 3.3 Objektivat e Programit te studimit (Ref. Nr.7.1)</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

## Standardi II.2

**Struktura, plani mësimor dhe shpërndarja lëndore e programeve të studimit me karakter profesional, është në përputhje me objektivat formuese, rezultateve të të nxënit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve dhe kërkesave të tregut të punës për këto programe.**

Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Emërtimi, struktura dhe shpërndarja e në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore është në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	<p>Elementët e programit të studimit, emërtimi i lëndëve, struktura e vitit akademik, ndarja në orë e kredite është në përputhje me parashikimet ligjore të nenit 70 të ligjit nr. 80/2015 dhe të VKM nr. 41, datë 24.01.2018, të ndryshuar me VKM nr. 879 datë 18.12.2019.</p> <p><i>Urdhëri i Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Nr. 567, datë 09/12/2018, për hapjen e Programit të Studimit me Karakter Profesional në "Turizëm", në Universitetin Evropian të Tiranës (Ref. nr. 54).</i></p> <p><i>VKM nr. 41, datë 24.01.2018 'Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë', i ndryshuar (Ref. nr. 53).</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Emërtimi, struktura dhe shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit, rezultateve të pritshme të të nxënit dhe punësimitin e studentëve.</p> <p><b>Kriteri 3.</b> Planu mësimor, natyra dhe emërtimi i moduleve/lëndëve, syllabuset e moduleve e të aktiviteteve formuese janë informuese dhe i përmbajnë të gjitha elementet e</p>	<p>Menyra e organizimit të të gjithë këtij programi studimi në semestra, shpërndarje të krediteve dhe moduleve perkatese mundëson objektivin e departamentit për të punësuar dhe rritur aftësitë e të nxënit të studentëve.</p> <p>Elementet e kërkuar janë standarte, të përfshira me kujdes në të gjithë elementet perkates brenda tij.</p> <p><u><i>Sikurse cituar edhe me lart GVJ sugjeron:</i></u></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Perdorim të literatures shqipe;</i></li> <li>• <i>Rifreskim here pas here të literatures se 5 viteve të fundit;</i></li> </ul>

<p>kërkuara.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Perdorim edhe te literatures te aplikuar ne turizem edhe ne ato raste kur lenda nuk ka lidhje me turizmin;</i></li> </ul> <p>Në funksion të arritjes së objektivave strategjike, Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut vlerëson si parësore aftësimin profesional të studentëve në programin e studimit me karakter profesional në “Turizëm”. DPT nëpërmjet programit të studimit, synon të pajisë studentët me njohuri teorike dhe praktike që të zhvillojnë një perspektivë të integruar dhe harmonizuar mbi kuptimin, përmbajtjen dhe zhvillimin e industrisë së turizmit dhe të mikpritjes. Prioritetet në këtë drejtim përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- përditësimin dhe përmirësimin e kurrikulës së programit të studimit, në përputhje me parashikimet ligjore, njohuritë në fushën e studimit dhe kërkesat e tregut të punës, bazuar në një proces të mirëpërcaktuar në aktet rregullatore të UET dhe kontaktet me Bordin e Tregut të Punës;</li> <li>- vënien në zbatim të marrëveshjeve të bashkëpunimit me kompani që operojnë në fushën e turizmit;</li> <li>- realizimin e praktikave lëndore dhe profesionale në mënyrë të pavaruar me mbikqyrjen e një anëtari të stafit akademik dhe në rastin e internshipeve, të një përfaqësuesi të kompanisë.</li> </ul> <p><i>Urdhëri i Ministrisë të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Nr. 567, datë 09/12/2018, për hapjen e Programit të Studimit me Karakter Profesional në “Turizëm”, në Universitetin Europian të Tiranës (Ref. nr. 54).</i></p> <p><i>VKM nr. 41, datë 24.01.2018 ‘Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë’, i ndryshuar (Ref. nr. 53).</i></p> <p><i>VKM nr. 879, datë 18.12.2019, Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr.41, datë 24.01.2018, të Keshillit të Ministrave, “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë” (Ref.Nr.53)</i></p> <p><i>Diplomë Profesionale Turizëm, Kurrikula (Ref.Nr.14)</i></p> <p><i>Plani mësimor i Programit të studimit me karakter profesional në Turizëm (Ref.Nr.14.1)</i></p> <p><i>Rregullore Mësimore E Programit të Studimit DP- Turizëm (Ref. nr. 7).</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Ka një raport të balancuar midis moduleve/aktiviteteve të formimit teorik përkundrejt atyre</p>	<p>Strukturimi i lëndëve/moduleve është i përshtatshëm për realizimin e objektivave formuese të programit, ku praktika profesionale, si veprimtari formuese e programit, është e</p>

praktike (50:50). Rreth 25% e programit i dedikohet aftësisit në praktikë/punë konkrete në profesion.

**Kriteri 5.** Klasifikimi sipas aktiviteteve formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues dhe orientimin e studentit drejt studimeve të mëtejshme dhe/ ose në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.

detyrueshme dhe kusht i domosdoshëm për të përfunduar studimet. Ne brendesi të syllabuseve dhe programit vihen re një perkujdesje për të krijuar një ndarje midis teorisë dhe praktikës, si i rëndësishëm në këtë program profesional. Megjithatë numri i madh i lendeve teorike, shpesh të panevojshme për këtë program studimi, përben një vështirësi për të mbajtur këtë raport në nivele optimale. Kështu, sugjerimit tek kriteret e mesipërme lidhur me riorganizimin e lendeve dhe moduleve në të ardhmen, për të zvogeluar ato dhe për t'i përshtatur me shumë me filozofinë e diplomes, i shtohet edhe kjo si arsye.

Bazuar mbi planin mesimor dhe raportin e moduleve teori/praktike, Departamenti në krijimin e kësaj kurrrikule ka konceptuar dy grupe të mëdha lëndesh/modulesh ku grupi i parë përben formimin teorik, që përfshin lende të një formimi baze teorik dhe grupi i dytë përben formimin praktik i cili përfshin gjithë lëndet e lidhura me degen e turizmit. Në grupin e parë me 56 kredite në total, ngarkesa mesimore përmban 1400 ore mesimore në total nga të cilat 375 përbejnë leksione dhe 1027 (duhet të ishte 1025, por është një diferencë e paperfillshme) përbehen nga seminarët dhe orët e kolonës së tretë që janë kontrolle dhe veprimtari praktikë. Në grupin e dytë të formimit praktik me 54 kredite, ka një ngarkesë mesimore prej 1350 orësh nga të cilat 562,5 janë leksione dhe 787,5 seminare dhe orët e veprimtarive praktikë. Nëse do të vendosnim këtu edhe pjesën e praktikave (125) dhe projektin profesional (125) prej 10 kreditesh gjithsej pra 250 ore atëherë në total pjesa praktikë do të konsiderohej me shumë se 50% e gjithë totalit  $(1350+250)/3000=53,3\%$  e të pjesës praktikë. Për GVJ jo domosdoshmërisht kjo është një gjë që nuk përmbush kriterin, pasi ky lloj programi ka nevojë për njohuritë praktikë shumë më tepër se sa llojet e tjera programesh. Përkundrazi GVJ mendon që ky është një aspekt pozitiv i programit. Por duhet të nënvizojmë se formimi praktik në diplomën profesionale nuk vjen thjesht nga modulet, pra gjykojmë se teresia e 1350 orëve nuk është e gjitha formim praktik pasi brenda ka leksione dhe formim teorik të palidhur me Turizmin (kryesisht marketing) edhe në këto lende/module. Ndërsa sa i përket kriterit të 25% të programit prej aftësisit praktik (aktualisht 725 ore përkundrajt 3000 orësh përben 24,1% të programit) pjesa e formave të

	<p>kontrollit të vazhdueshëm dhe seanca të praktikave profesionale është llogaritur si pjesë e këtij 25%, konkretisht 475 ore, gjykojmë se edhe kjo nuk është teresisht pjesë praktike, sepse sipas syllabuseve ka ore kontrolli që nuk kanë lidhje me praktiken, sidomos edhe tek grupi i lendeve të formimit teorik. Pra në aspektin formal mund të themi se kurrikula pothuajse i përmbush kriteret, por GVJ gjykon se në aspektin thelbësor të përfshirjes së praktikës, mund të bëhet me shumë sidomos brenda seciles lende dhe duke përcaktuar numrin e saktë të oreve që lidhen me praktiken brenda seciles lende, duke u pasqyruar kjo edhe në syllabuset e lendeve.</p> <p>Për më tepër, vijimi i kontakteve të vazhdueshme me përfaqësues nga tregu i punës, garantojnë që në vijim ky kriter të përmbushet në thelb dhe përmbajtjes së oreve në auditor dhe jashtë tij. Ky komunikim me tregun e punës, do të mundësojë edhe në të ardhmen përshtatje të mundshme të programit me evoluimin e kërkesave të tregut të punës.</p> <p><i>GVJ sugjeron me shumë praktike mesimore brenda moduleve apo lendeve perkatëse, psh në lende bazike si matematike, statistike, kontabilitet (2), etj të behen dhe zhvillohen njohuri praktike për industrinë e turizmit, psh statistikat në turizëm, vecori të informatizimit apo digitalizimit në turizëm, etj. Kjo do përftonte me shumë dije praktike dhe kompetenca profesionale.</i></p> <p><i>Rregullore Mësimore E Programit të Studimit DP- Turizëm, 3.3 Objektivat e Programit të studimit (Ref. Nr.7.1)</i></p> <p><i>VKM nr. 41, datë 24.01.2018 'Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë', i ndryshuar (Ref. nr. 53).</i></p> <p><i>Plani mësimor i Programit të studimit me karakter profesional në Turizëm (Ref.Nr.14.1)</i></p> <p><i>Syllabuset e Lëndëve të ofruara në vite (Ref.Nr.19)</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>  <b>X</b>

**Standardi II.3**

**Përmbajtja e lëndëve, moduleve dhe formave të tjera formuese të programeve të studimit me karakter profesional është në përputhje me objektivat formuese, rezultatet e të nxënit dhe**




**kërkesat e tregut të punës për këto programe**

Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit përmban të dhëna të plota mbi përmbajtjen e moduleve/lëndëve të formimit teorik e praktik dhe aktiviteteve të tjera të formimit sipas strukturës e planit të studimit.</p> <p><b>Kriteri 2.</b> Përmbajtja e programit të studimit është aktuale, i plotëson kërkesat e veçanta të profesionit dhe kërkesat për aftësitë shprehite e kërkuara/të pritshme nga punëdhënësit.</p>	<p>Përmbajtja e programit të studimit është aktuale dhe i plotëson kërkesat e veçanta të profesionit dhe kërkesat e tregut të punës. Plani mësimor është i qartë dhe në të janë të paraqitura lëndët/modulet me gjithë ngarkesën e tyre. Në planin mësimor ngarkesa mësimore është e përcaktura qartë po ashtu edhe forma e mësimdhënies për çdo lëndë. Pothuajse të gjithë lëndët që zhvillohen në këtë program studimi janë konceptuar me 6 kredite.</p> <p>Nga analiza e dokumentacionit, konstatohet se:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>• Programi zgjat 2 (dy) vite/4 (katër) semestra;</li><li>• Në total 120 kredite në dy vite akademike, 60 Kredite/vit;</li><li>• 20 lëndë + Praktikë dhe zhvillim studentit + Provim formimi (PPP)/Projekt profesional;</li><li>• 20 provime/lëndë + praktika + diploma (Provim formimi(PPP)/Projekt profesional);</li><li>• Ngarkesa totale në auditor është: Viti I 563 orë, Viti II 632 orë, Gjithsej 1195 orë mësimore në auditor;</li><li>• Format e mësimdhënies në planin mësimor janë: Leksione, Seminare, Praktikë profesionale, Punim i Diplomës (Provim formimi/PPP);</li><li>• Jepen kreditet korresponduese për çdo lëndë, për praktikën dhe për diplomën (Provim formimi/PPP);</li></ul> <p><i>Diplomë Profesionale Turizëm, Kurrikula (Ref.Nr.14)</i> <i>Plani mësimor i Programit të studimit me karakter profesional në Turizëm (Ref.Nr.14.1)</i> <i>Silabuset e Lëndëve të ofruara në vite (Ref.Nr.19)</i> <i>VKM nr. 41, datë 24.01.2018 'Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë', i ndryshuar (Ref. nr. 53).</i> <i>Plani mësimor i Programit të studimit me karakter profesional në Turizëm (Ref.Nr.14.1)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Përmbajtja parashikon zhvillimin e aftësive të transferueshme, e shtrirë edhe në modulet e përmbajtjen e tyre, gjatë zhvillimit të kurrikulës dhe në</p>	<p>Ky program mundëson përfitimin e aftësive të transferueshme, pasi i hap mundësi studentëve tanë të punojnë në sektorë publike dhe jo-publikë, si psh: specialistë të turizmit në administratën lokale, menaxherë të shërbimeve hoteliere dhe</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



metodat e mësimdhënies dhe vlerësimit.

**Kriteri 4.** Modulet dhe aktivitetet e formimit teorik e praktik/punë konkrete mundësojnë përfitim e njohurive, aftësive dhe shkathtësive ndërkurrikulare, të menduarit kritik, zgjidhjen e problemeve në kontekste konkrete, komunikimin dhe marrëdhëniet me të tjerë, si dhe orientimin cilësor në përvojën e punës.

restorante, specialistë agjensish turistike, tour operatorë dhe specialistë të departamenteve të vecanta dhe zyra të zhvillimit të turizmit, etj. Pavaresisht perpjekjes për të ofruar një program cilësor i cili synon të mbajë një raport korrekt midis aktiviteteve të formimit teorik dhe atij praktik, nga takimi në institucion është rakordësuar se:

*Eshtë e nevojshme përfshirja e me shumë lendeve/moduleve që lidhen dhe referohen direkt formimit të përgjithshëm në turizem.* Kështu grupi i vlerësimit të jashtëm ka konsideruar, por edhe bere me dije në të gjitha takimet e organizuara në institucion se marrja e njohurive, dhe rrjedhimisht e kompetencave të plota në turizem është e pamjaftueshme vetëm me ofrimin e 2 apo 3 lendeve të lidhura direkt me turizmin. Kështu lenda "Baza turizmi" është lende bazike dhe mjaft e rëndësishme, por e pamjaftueshme të përballojë njohuritë që duhet të marrë student. Kjo edhe sepse lendet e tjera si: Hyrje në trashëgimi kulturore dhe Komunikim nderkulturor, nuk i kanë të orientuara syllabuset dhe brendinë e tyre në drejtim të turizmit dhe njohurisë së specializuar. Apo lende si manaxhim i produktit dhe cmimit nuk ofrojnë njohuri të specializuara dhe fokusuara për turizem por janë të përgjithshme apo në marketing.

Departamenti vlerëson si prioritet zhvillimet në sferën e botimeve dhe materialit akademiko-pedagogjik, përfshirë investimet në organizimin e konferencave, tavolinave të diskutimit si edhe seminareve të tjera për të mundësuar diskutimin mbi arritjet më bashkëkohore të fushës. Prioritete të tjera në këtë drejtim përfshijnë:

- rritjen numrit të botimeve shqip në fushën e programit, përmes angazhimit të stafit akademik efektiv dhe të ftuar;
- nxitjen e zhvillimit të projekteve praktike mësimore përmes angazhimit të stafit akademik efektiv dhe të ftuar, me përfshirjen e studentëve të programit;

GVJ sugjeron:

*Shtimin e lendeve/moduleve të turizmit, ose ofrimi i një moduli me shumë kredite i ndare në dy lende. Pra, përveç lendeve të bazave të turizmit apo Hyrje në industrinë e mikrpritjes, sugjerohet edhe lende si: marketing i turizmit ose lende që lidhen me digitalizimin në turizem, me SME apo start-up në turizem, me sektori hotelier apo ndermarrjet e udhetimeve.*

	<p><i>Diplomë Profesionale Turizëm, Kurrikula (Ref.Nr.14)</i></p> <p><i>Plani mësimor i Programit të studimit me karakter profesional në Turizëm (Ref.Nr.14.1)</i></p> <p><i>Silabuset e Lëndëve të ofruara në vite (Ref.Nr.19)</i></p> <p><i>VKM nr. 41, datë 24.01.2018 'Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë', i ndryshuar (Ref. nr. 53).</i></p> <p><i>Plani mësimor i Programit të studimit me karakter profesional në Turizëm (Ref.Nr.14.1)</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Bashkëpunimi me punëdhënësit, internship-i/përvoja praktike, tutorazhi, e vlerësimi i tyre në profesion është e mjaftueshme, e përshtatshme dhe garanton formimin praktik në përputhje me kërkesat e profesionit.</p>	<p>Vihet re një bashkëpunim intensive i institucionit me aktoret e rendesishem si operatorët turistike përmes se cileve janë organizuar fizikisht por edhe online seanca nderveprimi me studentët. <i>Sugjerohet me shume praktike brenda lendeve apo moduleve te vecanta.</i> Psh brenda bazave të turizmit duhet të ketë me shume ore praktike. Në këtë mënyrë sigurohemi që studentët në këtë diplomë profesionale ka marrë me shume njohuri praktike mbi dijet që ka përfunduar brenda atij moduli. Aq më tepër, kjo merr rëndësi në kushtet kur numri total i lendeve/moduleve të lidhura direkt me turizmin është relativisht i ulët.</p> <p>Departamenti ka prioritet në bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar. Aktiviteti akademik i Departamentit mbështetet në vizionin e UET për ndërkombëtarizimin e institucionit. Në kuadër të këtij vizioni, dhe në funksion të arritjes të objektivave strategjike të programit të studimit, Departamenti vlerëson si prioritet rritjen dhe fuqizimin e bashkëpunimit kombëtar dhe ndërkombëtar nëpërmjet nënshkrimit të marrëveshjeve konkrete. Ky prioritet krahas ndërkombëtarizimit, përfshin dhe drejtime të tjera të ndërlidhura si: punësimin e studentëve, ofrimin e shkëmbimeve studentore dhe të stafit akademik, përditësimin e kurrikulës së programit, mundësimin e projekteve studimore, botimeve akademike.</p> <p><i>Diplomë Profesionale Turizëm, Kurrikula (Ref.Nr.14)</i></p> <p><i>Lista e subjekteve dhe institucioneve bashkëpunuese. (Tabela 5), pjesë e anekseve të Raportit (Ref.Nr.32)</i></p> <p><i>Lista e subjekteve dhe institucioneve bashkëpunuese. (Tabela 5), pjesë e anekseve të Raportit (Ref.Nr.32)</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

#### Standardi III.1

**Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional përmes politikave e udhëzimeve të posaçme dhe mbështetet në metodat dhe praktikat më të mira të fushës**

Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues të posaçëm, ngre struktura të posaçme dhe zhvillon mekanizma të vlerësimit e të monitorimit të cilësisë së mësimdhënies dhe metodave të përdorura dhe aftësive të stafit të angazhuar, duke përfshirë aktivisht studentët në këtë proces. Rezultatet e këtyre vlerësimeve bëhen publike.</p>	<p>Njësia përgjegjëse e programit të studimit, Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut në bashkëpunim me KSBC kujdeset për monitorimin e procesit mësimor dhe garantimin e mësimdhënies cilësore duke marrë veprime konkrete përmirësuese në nivelin e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Kjo konstatohet përmes rregulloreve dhe udhëzuesve në nivel institucional, si dhe nga vizita në institucion. GVJ konstaton gjithashtu se UET angazhon personelin akademik në punë kërkimore dhe pedagogjike brenda dhe jashtë vendit (takimi me pedagogët e programit, takimi me zyrën e projekteve) e cila i mundëson këtij stafi ndjekjen e zhvillimeve më të fundit të fushave të lidhura me fushën e turizmit. Nga pikëpamja e sistemeve dhe strukturave të teknologjisë, përmes sistemit LMS, UET ka mundësi të aplikojë format e të mësuarit e-learning, duke ofruar materialet në sistem elektronik si video, teste, forume, animacione të cilat ndihmojnë personelin të krijojë metoda më novatore dhe të standartizuara të mësimdhënies.</p> <p><i>Rregullore mësimore e programit të studimit DP Turizëm (ref. nr 7).</i></p> <p><i>Broshura të dokumenteve në zbatim të statutit të UET, 1. Mbi organizimin dhe funksionimin e Dekanatit dhe Departamentit (Ref nr.6)</i></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>2. <i>Formulari I vlerësimit të pedagogut nga eprori kolegu (Ref 30.1)</i></li> <li>3. <i>Formulari I vlerësimit të pedagogut nga studenti (Ref 30.2)</i></li> <li>4. <i>Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë (Ref. Nr. 8)</i></li> <li>5. <i>Plani I veprimit KSBC (ref. nr. 30.3)</i></li> </ol>

<p><b>Kriteri 2.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra e kursit/eseja, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni e që është e përshtatshme për realizimin e programit të studimit.</p>	<p>Në programin e studimit DP Turizëm, format kryesore të mësimdhënies janë:</p> <p>Leksionet (2 orë në javë për çdo lëndë);</p> <p>Seminare (1 orë në javë për çdo lëndë);</p> <p>Projekte/Detyra, (pjesë e vlerësimit të lëndës);</p> <p>Praktikë profesionale;</p> <p><i>Mund të themi se ka laboratorë të përgjithshëm, por këtu mungojnë disa mjedise laboratorike specifike për Turizmin, të cilët do të garantonin më mirë aspekte të mësimdhënies në nivel profesional, aplikativ dhe praktik. Sa i përket praktikave ato janë të parashikuara sipas lëndëve duke përshtatur detyrat praktike të kërkuara në cdo lëndë, si dhe praktikat si pjesë e planit mësimor të studimit. Metodot e transferimit të njohurive tek studentët janë bashkëkohore dhe përfshijnë mjete audio-vizive dhe sistemin online LMS që ndihmon në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Nga takimi me studentët u evidentuan lehtësitet e sistemit LMS në rritjen e interaktivitetit me pedagogun dhe jashtë auditorit. Gjithashtu gjatë periudhës së Pandemisë, është përdorur edhe platforma TEAMS për realizimin e orëve dhe kjo ka mundësuar rritjen e përdorimit të teknologjisë. Është menduar që aspektet praktike të cilat ishin planifikuar, por nuk janë zhvilluar dot për shkak të gjendjes së pandemisë, të riplotësohen nëpërmjet aktiviteteve të tjera me përfshirjen e praktikienëve të fushës, aty ku ka qenë e mundur.</i></p> <p><i>UET LMS guidë për studentët (Ref nr 46.3)</i></p> <p><i>Vizita në institucion, takimi me pedagogët e programit, takimi me studentët e programit</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Personeli akademik përdor forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, në përgjigje dhe të diversitetit dhe nevojave të studentëve.</p>	<p>Format e ndryshme, metodat e mësimdhënies janë praqitur në syllabuset e lëndëve të programit të studimit, sipas literaturave përkatëse, më konkretisht në seksionin e metodës pedagogjike të seminarëve, ku bien në sy përdorimi i rasteve të studimit, diskutimet dhe zgjidhjet e ushtrimeve aty ku është relevante. Nga vizita në institucion, takimi me pedagogët e programit dhe studentët e programit, gjithashtu janë përmendur edhe forma si leksionet e hapura me Guest speaker, si dhe forma të tjera të punëve praktike, ku janë marrë parasysh disa kushte të vetë studentëve të këtij program, të cilët një pjesë kanë përvojë pune në sektor.</p> <p><i>Syllabuset e lëndëve;</i></p>

	<i>Vizita ne institucion;</i>			
<b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik I angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies, përfshirë ato interactive e gjithëpërfshirëse, sipas tematikave dhe profilit.	<p>Kompetenca e personelit akademik të angazhuar në mësimdhënie në këtë program studimi evidentohet përmes CV të stafit, ku vihet re një përshtatje e angazhimit të stafit në punën kërkimore shkencore dhe zhvillimit të karrierës së stafit me lëndët e përcaktuara në këtë program. Gjithashtu sipas syllabuseve vihet re se gjithë anëtarët kanë përdorur llojshmërinë e formave të mësimdhënies të përmendura më sipër. Vijimësia e programit gjatë pandemisë me mësimdhënien online edhe përmes platformës TEAMS, vec platformës së mëparshme LMS, ka mundësuar që stafi të aftësohet gjithashtu më tepër në përdorimin e mjeteve teknologjike online, përvec atyre të mëparshme si kompjutera, videoprojektorë, tableta.</p> <p><i>CV e stafit të programit (ref. nr 20)</i></p> <p><i>Syllabuset e lëndëve të programit (ref 19)</i></p> <p><i>Urdhër I rektorit për vijimin e procesit akademik, në vitin 2019-2020, në kushtet e shkaktuara nga pandemia COVID 19 (ref. nr 5.1)</i></p>			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të mbështesë stafin përmes njohjes me shembujt e praktikave të mira, të nxisë dhe të inkurajojë personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies.	<p>Institucioni nxit dhe motivon stafin përmes mekanizmave të vlerësimit të pedagogut, mënyra të cilat evidentohen në statutin dhe rregulloren e UET, si dhe në dokumentacionin e dosjeve të pedagogëve ku pjesë janë edhe vlerësimi i performancës Institucioni u jep po ashtu mundësi pedagogëve të trajnohen dhe të zhvillohen sidomos në fushën e përdorimit të teknologjive dhe platformave digjitale.</p> <p><i>Rregullore (Ref. nr 5)</i></p> <p><i>Statuti (Ref nr 2)</i></p> <p><i>UET LMS guidë për studentët (Ref nr 46.3)</i></p> <p><i>Vizita në institucion: takimi me zyrën e Burimeve njerëzore</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### Standardi III.2

**Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike të nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor**

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranç gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Procesi mësimor teorik e praktik, realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.</p>	<p>Infrastruktura e shfrytëzueshme për këtë program studimi është e mjaftueshme, funksionale dhe cilësore për realizimin e objektivave të këtij program studimi.</p> <p>UET ndodhet në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta” nr 70, H1 Tiranë, përfshin 3 godina me një sipërfaqe prej 11,500 m<sup>2</sup> pa llogaritur sipërfaqet e jashtme në dispozicion për veprimtari shërbimi, shlodhëse rekreative. Të ndara në 3 godina, sipërfaqet funksionale përfshijnë sallë të madhe Aula Magna, Salla leksionesh e seminaresh, salla laboratorësh dhe bibliotekën. Këto sipërfaqe përgjithësisht nuk janë të ndara sipas fakulteteve apo degëve të studimit (përvec në rastet e vecanta të degëve të artit që kanë nevoja specifike për laboratorë dhe salla, apo aspekte teknike). Kështu, në dispozicion të këtij program studimi janë laboratorë të informatikës, aty ku është e nevojshme, sallat e leksioneve dhe seminareve të cilat janë të përbëra nga videoprojektor, foni, kompjuter desktop/laptop dhe/ose tableta si edhe sipërfaqen dhe infrastrukturën e bibliotekës. Kjo e fundit përbëhet nga 150 vende leximi, 14 PC në një sipërfaqe prej 300 m<sup>2</sup>. Mjediset janë gjithashtu të pajisura me sistemin “fan cool” dhe me EïFi.</p> <p><i>Vizita në institucion;</i></p> <p><i>Infrastruktura në dispozicion të programit të studimit (Ref nr. 42)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor, si dhe sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.</p>	<p>Sistemet informative që janë në dispozicion në UET janë dy.</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. UET funksionon me sistemin LMS, sistem i menaxhimit të brendshëm të informacionit. Procesi mësimor mbështetet nga sistemi LMS (Learning Management System), i cili bën të mundur që studenti të informohet nga pedagogu kudo që ndodhet dhe të ndërveprojë me kolegët e kursit online, si dhe të ketë akses në vlerësimet me pikë dhe nota;</li> <li>2. Gjatë periudhës së pandemisë UET gjithashtu futi në përdorim platformën MS TEAMS, e cila përmban gjithashtu të gjitha programet e paketës së plotë office 365, në mbështetje jo vetëm të procesit të mësimdhënies online, por edhe procesit të punës individuale të studentit jashtë auditorit, por edhe të punës së pedagogut për përgatitjen e materialeve,</li> </ol>

	<p>ndërveprim etj;</p> <p>Studentët kanë akses në bibliotekën elektronike, ku studentet dhe stafi mund të shkarkojnë artikuj shkencor, përkatësisht ne Ebsco, Sage abonim 5 vjecar. Biblioteka ka një staf të gatshëm në ndihmë të studentëve. Nga informacioni i paraqitur në RVB dhe konstatimet tona nga vizita në institucion, vlerësojmë se UET ka infrastrukture të konsoliduar për realizimin e programit mësimor. UET ka një system të brenshëm komunikimi me adresat e e-mail në outlook.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Gjuha e programit të studimit është gjuha shqipe. Në syllabuset e lëndëve janë të vendosura literaturat sipas parimeve të ndërtimit të porgramit të lëndës, literature e detyrueshme dhe literature e rekomanduar. Vihet re se shumica e literaturave janë në gjuhë të huaj.</p> <p><i>Pra mungon referenca në literaturë Shqipe</i>, ndërkohë që programi është në nivel diplome profesionale dhe ka nevojë për literaturë në Shqip. Megjithatë, GVJ në takimin me pedagogët e programit, lidhur me literaturën e përdorur, mori informacion se ka materiale të përkthyer të vetë pedagogëve, të vendosura në dispozicion për studentët përmes LMS.</p> <p><i>Mbi parimet e ndërtimit të syllabusit të lëndëve (Ref nr. 39)</i>  <i>Formati I syllabusit, cikli I parë dhe I dytë (ref nr 19.2)</i>  <i>Takimi me pedagogët e programit'</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>UET në kuadër të fuqizimit të procesit mësimdhënies dhe kërkimit shkencor ka bërë të mundur që stafi dhe studentët të kenë akses në disa librari elektronike, duke u abonuar për një periudhë 5 vjecare në SAGE &amp; EBSCO si dhe Questia. Biblioteka ka gjithashtu akses në dy platforma elektronike përmes shoqatës së bibliotekave, ASTM compass dhe Edëard Elgar Publishing</p> <p><i>Biblioteka online (Ref nr 45)</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>UET ka vendosur në dispozicion të studentëve katër laboratorë të pajisur me kompjutera ku janë instaluar të gjitha programet (Software) për realizimin e punës së pavarur nga studenti. Këto laboratorë janë pajisur dhe përmes projekteve të ndryshme ndërkombëtare në të cilat ka marrë pjesë universiteti. Laboratorët mësimorë janë të pajisur me mjetet didaktike të nevojshme për zhvillimin e</p>



	<p>praktikës mësimore. GVJ u njoh me laboratorët e UET, në vecanti me Laboratorin e Novacionit, ku është instaluar dhe printer 3D dhe gjithashtu janë zhvilluar takime dhe aktivitete edhe të lidhura me natyrën e programit të studimit (Industria e Turizmit dhe nevoja për Burime njerëzore). Duke qenë se viti i fundit, vit kur edhe është zhvilluar programi i studimit është viti i pandemisë dhe mësimi online, nuk mund të thuhet se studentët e këtij programi kanë patur mundësi të përdorin laboratorët, por vlen të thuhet se Laboratorët në dispozicion të gjithë studentëve në periudha normale janë të mirëpajisur dhe gjithashtu u krijojnë mundësi studentëve për akses dhe përdorim, sa herë kanë nevojë brenda orareve të prezencës në UET.</p> <p><i>Infrastruktura në dispozicion të programit të studimit (Ref nr. 42)</i></p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>	<p>Nga pikëpamja e infrastrukturës teknologjike UET ka investuar në sistemet e fundit kompjuterike me Sisteme operative Ëindoës 10, laboratorë, lidhje internet ËiFI për të gjitha mjediset. Por më e rëndësishmja, procesi mësimor mbështetet nga sistemi LMS (Learning Management System), i cili u shpjegua edhe më lart, si edhe platforma TEAMS që është tipike e një platforme të mirëfilltë e-learning. Nga informacioni i paraqitur në RVB dhe konstatimet tona nga vizita në institucion, vlerësojmë se UET ka infrastrukture të konsoliduar lidhur me platformat mësimdhënëse, për realizimin e programit mësimor.</p> <p><i>Urdher administrativ “mbi zbatimin e plotë të procesit mësimor administrative të platformës UET - LMS (Ref. nr. 46.1)</i></p> <p><i>UET – LMS guidë për pedagogun (Ref nr 46.2)</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;">X</p>

### Standardi III.3

**Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat garantojnë cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit dhe rritjen e vetëdijes për përmirësimin e tyre**

Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni organizon</p>	<p>Në funksion të procesit mësimor-kërkimor, UET ka</p>

<p>struktura/njësi në nivel institucional që ndjekin, vlerësojnë dhe monitorojnë procesin e mësimdhënies dhe koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së saj.</p>	<p>organizuar stuktura të posaçme që promovojnë përmirësimin e cilësisë. Njësitë ndihmëse në funksion të procesit mësimor- kërkimor janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Zyra e Standardeve dhe Cilësisë, e cila kujdeset për hartimin, përditësimin dhe rishikimin e kuadrit rregullator të institucionit dhe procedurave, në përputhje me legjislacionin në fuqi, standardet e cilësisë dhe praktikat e mira kombëtare dhe ndërkombëtare, si edhe monitoron zbatueshmërinë e tyre nga strukturat dhe personeli i institucionit;</li> <li>- Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, nëpërmjet vlerësimit të efikasitetit të veprimtarive që ushtrohen në UET, me synim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë;</li> </ul> <p>Veprimtaria e KSBC përfshin monitorimin e vazhdueshëm të institucionit në;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndjekjen e vazhdueshme të programeve të lëndëve, zbatimit, rishikimit, përditësimit të tyre, nëpërmjet krijimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të performances;</li> <li>• Ndjekjen e vazhdueshme të nivelit të cilësisë së stafit akademik dhe ndihmës, si edhe kualifikimit të tij;</li> <li>• Monitorimi i vazhdueshëm i procesit të mësimdhënies dhe i vlerësimit të studentëve dhe ruajtja e cilësisë së tij;</li> <li>• Ndjekja e vazhdueshme e ecurisë së kërkimit shkencor në institucion;</li> </ul> <p>Këto njësi ndjekin me përgjegjshmëri problemet që lidhen me mësimdhënien, vlerësimin institucional dhe zhvillimet mësimore në rritjen e cilësisë së formimit të studentëve. Veprimtaria e tyre miratohet dhe rregullohet nga Senati i Universitetit.</p> <p><i>Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë ( Ref nr. 8)</i>  <i>Statuti I UET (Ref nr. 2)</i>  <i>Plani I veprimit KSBC (ref nr 30.3)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për procesin e mësimdhënies, cilësinë e saj dhe rritjen e vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e</p>	<p>Cilësia e procesit të mësimdhënies është në fokus të Departamentit të Menaxhimit dhe Marketingut si dhe Fakultetit të Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit. Në kuadër të rritjes dhe përmirësimit, të performances akademike - mësimore, këto dy njësi bashkëpunojnë ngushtësisht me</p>

<p>studimit që ofron.</p>	<p>KSBC-në për garantimin e cilësisë gjatë ushtrimit të veprimtarive akademike, kërkimore, të personelit akademik dhe të studentëve. Institucioni ofron mundësinë e trajnimeve dhe ëorkshopeve të ndryshme të cilat orientojnë personelin akademik dhe personelin mësimor-shencor në përditësimin dhe kualifikimin e mëtejshëm profesional. Gjithashtu për zhvillimin e metodave të reja të mësimdhënies, ndiqen si praktikë leksionet e dhëna nga lektorë të ftuar vendas të cilët janë personalitete në fushën e tyre, por dhe të huaj, pjesë e të cilëve janë dhe nga programi ERASMUS+. Të gjitha këto shkëmbime i shërbejnë rritjes së vetëdijes të personelit akademik dhe studentëve për cilësinë e mësimdhënies dhe programit të studimit.</p> <p><i>Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë (Ref. nr 8)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja, në përputhje me natyrën dhe specifikën e programeve profesionale.</p>	<p>Personeli akademik pohoi se ka punuar vazhdimisht për përmirësimin e mësimdhënies, në aspekte si syllabuset e lëndëve dhe metodat e zhvillimit të oërve me studentët. Në takimin me pedagogët u evidentua nga GVJ se syllabuset e së njëjtës lëndë që jepet në disa programe, psh, në bachelor dhe në DP Turizëm, nga pikëpamja zyrtare janë njësoj, por vetëm gjatë zbatimit në klasë pedagogët bëjnë diferencën midis programeve të ndryshme, duke u fokusuar në DP tek rastet studimore dhe mundësi të aftësimit në praktikë. Në këtë aspekt u sygjera që këto elemente të zbatimit të diskutohen për tu evidentuar edhe nga pikëpamja e dokumentacionit zyrtar, psh, shtojcë syllabusi ose ndonje formë tjetër dokumentacioni.</p> <p>Sa i përket personelit ndihmësakademik, gjatë vizitës në institucion u konstatua se Përgjegjësi i Departamentit në bashkëpunim me Sekretarinë Mësimore monitorojnë zhvillimin e procesit mësimor. Institucioni ofron trajnime ndërkombëtare ne kuader te programit Erasmus+ për stafin akademik dhe personelin ndihmes akademik për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja nëpërmjet praktikës së leksioneve të hapura. Pjesëmarrja në projekte apo shkëmbime për këtë program specifik nuk aplikohet, pasi ka vetëm një vit që është hapur dhe ky është pikërisht viti pandemik, por zyra e projekteve pohon se, pavarësisht se nuk ka partneritete Erasmus+ per kete DP turizëm, kjo diplomë do të shihet me prioritet në thirrjen e re Erasmus + dhe aktualisht po</p>

	<p>gjurmone partnere te huaj.</p> <p><i>(Vizita në institucion, takimi me pedagogët e programit; takimi me përgjegjësën e departamentit; takimi me sekretarinë mësimore; takimi me zyrën e projekteve)</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies përmes trajnimeve të vazhdueshme të personelit akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të tyre.</p>	<p>Referuar RVB - se, Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut ka realizuar leksione të hapura me pjesëmarrje pedagogë apo specialistë të mirënjohur të fushës së turizmit, me synim marrjen e përvojës metodologjike dhe pedagogjike nga personeli akademik. UET ka strukturat e duhura për të ofruar trajnimeve dhe ëorkshope për personelin akademik, Konkretisht Qendra për Kërkim Shkencor dhe Metodologji në UET. Stafet akademike sjellin përvoja të reja përmes shkëmbimeve në programet Erasmus, në shumë programe studimit dhe sidomos edhe në programet e ofruara nga Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut, por sic u tha edhe më lart të kriterin 3, nuk mund të evidentohen fakte në këtë program si program i ri, por vetëm për pedagogët e programit.</p> <p>Sa i përket eksperimentimit të metodave të reja, këtu nuk shihen evidenca të përfshirjes së metodave më të fundit inovative, sic janë ato të “Learning by doing”, të mësuarit përmes lojës, të mësuarit në mjedise të tjera, etj, por mbetemi tek aplikimi përmes rasteve studimore, diskutimeve në klasë, apo përdorimi i materialeve video dhe audio. <i><u>GVIJ sygjeron plotësimin dhe shumellojshmerine e metodave apo dhe kombinimeve te ndryshme.</u></i></p> <p><i>Raporti i mobiliteteve të zyrës së projekteve dhe partneriteteve, marrëveshje active Erasmus plus KA107 zbatuar gjatë 2019-2020 (Ref. nr. 43.2)</i></p> <p><i>Vizita në institucion, takimi me pedagogët e programit</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.</p>	<p>Një formë e testimit të metodave të përdorura në mësimdhënie është ajo përmes marrjes së feedback nga studentët nëpërmjet focus grupeve lidhur me procesin mësimor si dhe diskutimi nga stafi akademik dhe Përgjegjësi i Departamentit i aplikimit tek studentët. KSBC analizon efektet e pritshmëritë se studentëve në këto focus grupe dhe i raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet Përgjegjësit të Departamentit, i cili rishikon metodat e mësimdhënies me stafin akademik.</p> <p>Aktualisht nuk ka ndonjë evidencë të efekteve apo ndryshimeve të fakteve me pritshmëritë konkretisht për</p>

	<p>realizimin e ndonje metode innovative konkrete. Përshkrimi i efekteve mbetet thjesht në kuadrin e evidentimit të kënaqësisë nga studentët sa i përket procesit.</p> <p><i>Vizita në institucion, takimi me pedagogët e programit, takimi me NJSBC;</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

#### Standardi III.4

**Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme për vlerësimin e njohurive, dijeve dhe aftësiwe profesionale dhe garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën për çdo student.**

Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësiwe profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, të cilat bëhen publike. Institucioni mban dhe ruan dokumentacionin e vlerësimeve, ankimimet dhe rishqyrtimet e vlerësimit, sipas afateve e procedurave në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Bazuar në rregulloren e UET, format e kontrollit të dijeve përcaktohen në nenin 24 si më poshtë:</p> <p>Vlerësimi i përgatitjes akademike të studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm. Nota përfundimtare është rezultante e kombinimit të elementeve të mëposhtëm:</p> <p><i>24.1 Për lëndët e Tipologjisë I</i></p> <p>a. Provimit përfundimtar (40%)</p> <p>b. Detyrave praktike: 2 (dy) x 30% = (60%)</p> <p><i>24.2 Për lëndët e Tipologjisë II</i></p> <p>a. Provimit përfundimtar (40%)</p> <p>b. Provimit të ndërmjetëm (30%)</p> <p>c. Detyrës së kursit (20%)</p> <p>d. Nivelit të diskutimit në seminare (10%).</p> <p>Lëndët e programit të studimit DP Turizëm janë të tipologjisë I. Përshkrimi lidhur me formën e kontrollit dhe vlerësimit të njohurive vendoset në syllabusin e secilës lëndë të këtij programi Syllabusi ngarkohet në sistemin LMS nga ku mund të aksesohet lehtësisht nga studentët. Format e kontrollit gjithashtu vendosen në rregulloren e programit të studimit</p>

	<p><i>Rregullore e UE (ref. nr 5)</i></p> <p><i>Rregullore e programit të studimit (ref. nr 7)</i></p> <p><i>Formati i syllabusit, cikli I parë dhe I dytë (ref nr 19.2)</i></p> <p><i>Syllabuset e programit të studimit (ref. 19.1)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Testimi e vlerësimi i njohurive dhe aftësive profesionale realizohet në forma të ndryshme si: pjesmarrja aktive; plotësimi i detyrimeve (detyrave të kursit); testimet gjatë vitit; Provimi përfundimtar.</p> <p>Vlerësimi i studentit ndahet në vlerësim i vazhduar gjatë vitit për elementët e përcaktuar në programin e modulit, si dhe vlerësimi përfundimtar. Duke shqyrtuar Syllabuset e lëndëve rezultoi se raporti është në masën 40% (provimi përfundimtar) dhe 60% vlerësimi i vazhduar gjatë vitit (aktivizimi, detyra kursi, testime). Kjo formë inkurajon angazhimin aktiv të studentëve gjatë kursit.</p> <p><i>Rregullore e programit të studimit (ref. nr 7)</i></p> <p><i>Syllabuset e programit të studimit (ref. 19.1)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në fillim të çdo lënde/moduli, studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës /modulit.</p>	<p>Shkalla e vlerësimit të pkëve me shkrim dhe format e kontrollit të dijeve dhe pse gjenden në rregulloren e UET, u bëhen të ditur studentëve me programin e studimit, syllabusin e lëndës, që në javën e parë të fillimit të mësimin nga pedagogu i lëndës. Studentët e programit të studimit janë informuar në distance përmes sistemit LMS në lidhje me lëndët, përmbajtjen e tyre dhe metodologjinë e vlerësimit të njohurive.</p> <p><i>Rregullore e programit të studimit, pika 5.1 dhe 5.2 (ref. nr 7)</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik, duke venë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat garantojnë anonimatit, eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Referuar RVB-se, vlerësimi gjatë vitit përmes detyrave dhe provimeve të ndërmjetme të cilat zhvillohen si rregull në javën e 7-të, inkurajon angazhim dhe ndërveprim të studentit dhe e përgatit atë për sezonin e provimeve. Vlerësimi gjatë vitit dhe vlerësimi përfundimtar gjenden në formë elektronike përmes sistemit LMS. Gjithashtu rezultatet e studentit dokumentohen në dokumenta si regjistri i pedagogut dhe pasqyra e vlerësimit dhe depozitohen në Sekretarinë Mësimore. UET i kushton shumë rëndësi transparencës dhe privatësisë së vlerësimit. Vendosija e rezultateve në sistemin elektronik LMS, lejon secilin student të shikojë vetëm vlerësimin e tij dhe askush tjetër nuk ka akses për të parë vlerësimet e tjetrit. Gjithashtu vlerësimi bëhet në kohë. Ndërkohë UET ka</p>

	<p>përdorur edhe format e vlerësimit në mënyrë elektronike (nëpërmjet Clean Score), një nga format bashkëkohore të kontrollit të njohurive dhe vlerësimi i studentëve. Përdorimi i sistemit TEAMS gjithashtu lejon vlerësimin elektronik të testeve dhe quizeve që realizojnë pedagogët gjatë semestrit dhe këto reduktojnë abuzimin dhe subjektivitetin e vlerësimit të studentëve.</p> <p><i>Rregullore e UET (Ref. nr 5)</i>  <i>Kalendari akademi (Ref. nr 10.1, 10.2, 10.3)</i>  <i>UET – LMS guidë për studentët</i>  <i>Vizita në institucion, takimi me pedagogët e programit</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisione provimi, shoqërohet me komente e këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Vlerësimi i njohurive për cdo lëndë realizohet nga pedagogu titullar i lëndës, kur ky është i vetëm dhe nga pedagogët, kur ka më shumë se një pedagog lektor dhe seminarist për lëndën. Në këto raste komisioni i provimit përcaktohet nga Përgjegjësi i Departamentit. Në rastin e mbrojtjes së diplomave dhe Praktikës Profesionale, këto realizohen me komision përkatësisht me 5 dhe 3 anëtarë, ku në rastin e praktikës, njëri prej tyre është përgjegjësi i praktikës për departamentin. Vlerësimi i praktikës është kusht për përmbushjen e detyrimeve lidhur me kreditet e programit dhe me diplomimin.</p> <p><i>Rregullore e programit të studimit (ref. nr 7)</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse, duke garantuar njëkohësisht të drejtat e studentëve, për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me këto rregullore.</p>	<p>Sipas rregullores së UET provimet realizohen duke u mbështetur në procesin e sekretimit, i cili garanton vlerësimin mbi bazë të meritës dhe redukon subjektivitetin e vlerësimit. Në rastin e vlerësimeve gjatë vitit pandemik në rastet kur procesi është zhvilluar online, sigurisht që platformat garantojnë vlerësimin objektiv duke mbështetur forma të vlerësimit standarte.</p> <p>Sa i përket respektimit të të drejtave të studentit për tu njohur me vlerësimin dhe për të rishikuar vlerësimin kur nuk është dakort, kjo arrihet përmes garantimit të procesit nga rregulloret e UET dhe rregullorja e programit, si dhe nga zbatimi i këtyre procedurave nga pedagogu dhe kontrolli dhe përfshirja e përgjegjësit të departamentit, në rastet e nevojës për ngritjen e komisioneve vlerësuese sipas rastit përkatës.</p> <p><i>Rregullore e UET, neni 32 (Ref. nr 5)</i>  <i>Rregullore e programit të studimit (ref. nr 7)</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

### Standardi III.5

**Zhvillimi i programit të studimit, deri në diplomim, garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët duke dhënë njëkohësisht njohuri të aplikuara dhe kompetenca profesionale lehtësisht të përdorshme në tregun e punës, apo për studime të mëtejshme.**

Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë përfitim e njohurive, zhvillimin e aftësive profesionale dhe të veçanta të studentëve, që janë në përputhje me rezultatet e pritura të të nxënit për programet me karakter profesional.</p>	<p>Programi i studimit realizohet me 120 kredite, në gjuhë shqipe, me formë studimi me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 2 vite akademike (4 semestra), në përfundim të të cilit lëshohet diplomë profesionale në “Turizëm”. Në rregulloren e programit të studimit gjenden aftësitë dhe kapacitetet e studentëve që synon të krijojë programi, si njohuri e koncepte bazë, aftësi drejt një licence profesionale, aftësi për punë kërkimore aplikative, aftësi për punë praktike, aplikative, për promovim personal.</p> <p>Programi i studimit synon të pajisë studentin me njohuritë teorike bazë të menaxhimit dhe Turizmit, aftësitë praktike dhe aftësi për zhvillim karriere në profilin e turizmit në përputhje me tregun e punës. Kurrikula e programit të studimit përmban 5 kategori përmes të cilave studentët fitojnë një grup kopetencash të ndara në A) Lëndë bazë; B) Lëndë karakterizuese; C) Lëndë ndërdisiplinore/integruese; D) Lëndë plotësuese; E), Detyrime përmbyllëse; Sipas ketyre kategorive programi përbëhet nga lëndë përkatësisht:</p> <p>A) Lëndë Bazë 19 kredite (16%): 1. Hyrje në Sociologji, 2. Hartim dhe menaxhim projektsh, 3. Shkrim akademik, 4. Hyrje në administrim biznesi;</p> <p>B) Lëndë Karakterizuese 58 kredite (48%): 1.Parimet e kontabilitetit 2. Kontabilitet kosto, 3. Statistikë e aplikuar, 4. Hyrje në financë, 5. Matematikë 1, 6. Bazat e marketingut, 7. Bazat e turizmit, 8. Hyrje në trashëgiminë kulturore, 9. Komunikim ndërkulturor, 10. Sjellje organizative;</p> <p>C) Lëndë ndërdisiplinore 24 kredite (20%):1. Histori arti 2. Hyrje në industrinë e mikpritjes, 3. Sjellje konsumatore, 4.</p>



Menaxhim i produktit dhe i cmimit, 5. Trashëgimia natyrore dhe turizmi kulturor, 6. Muzeologji dhe muzeografi;

D) Lëndë plotësuese 14 kredite (12%): 1. Anglisht, 2. Bazat e Informatikës, 3. Praktike dhe Zhvillim studenti;

E) Detyrime përmbyllëse 5 kredite (4%): 1. Provim formimi/projekt profesional;

Të gjitha lëndët zhvillohen sipas Tipologjisë I, në mënyrë interaktive leksione e seminare nga lektorë të kualifikuar e të specializuar në fushat përkatëse. Ngarkesa është e balancuar mes semestrave dhe lëndët ndjekin një radhë që është e nevojshme për përvetësimin e tyre. Në syllabuset e detajuara janë specifikuar kompetencat që fitojnë studentët në secilën lëndë të programit të studimit.

Lidhur me aftësitë dhe kompetencat e krijuara nga programi i studimit në raport me lëndët, vihet re se duhet rregulluar një raport më i mirë tek lëndët ndërdisiplinore, ku raporti e kalon maksimumin prej 15% që duhet të kenë si peshë këto lëndë. Në fakt kjo nuk është vetëm një shifër por gjykojmë që lidhet pak me filozofinë e përgjithshme të programit dhe departamentit për tu dhënë studentëve njohuri dhe kompetenca të përgjithshme si ato të menaxhimit, marketingut, matematikë statistikë, financë, kontabilitet, duke zgjeruar kompetencat e përgjithshme dhe vetëm duke i specifikuar përmes shembujve/rasteve. Por në fakt edhe në aspekte teorike ka diferenca dhe literatura bashkëkohore e të përshtatshme që krijojnë njohuri specifike menaxheriale, marketing apo financë/kontabilitet për ndërmarrjet turistike. Ka lëndë si psh hyrje në industrinë e mikpritjes që është lëndë karakterizuese, dhe jo lëndë ndërdisiplinore apo integruese, që sipas planit edhe mund të mos zgjidhet fare nga studentët të cilët pastaj rezultojnë me mangësi të theksuar të njohurive specifike sa i përket industrisë së mikpritjes. Vihet re se mungojnë disa aftësi që merren përmes lëndëve të kudogjendura në programe të turizmit sic janë Menaxhimi në ndërmarrjet turistike, agjencitë e udhëtimit, Marketingu i turizmit, Destinacionet turistike etj. Ndërkohë që mund të zvogëlohet numri i krediteve apo të bashkohen lëndë me karakter të përgjithshëm në disa lëndë të përshtatura edhe nga ana teorike me industrinë turistike psh kontabiliteti në ndërmarrjet turistike, për t'iu lënë më shumë vend formimit të aftësive të specializuara për turizmin.



	<p><i>Rregullore e programit të studimit ( ref nr 7)</i></p> <p><i>Plani mësimor I programit të studimit (Ref. nr 14.1)</i></p> <p><i>Plani sipas A-E</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton njohuritë e përshtatshme dhe zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit, duke mbështetur diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave apo çështjeve të caktuara.</p>	<p>Njohuritë e studentëve lidhur me aftësi në fushën e teknologjisë jepen nga lënda Bazat e informatikës. Lënda bazuar në programin nuk jep njohuri specifike për programet e shumta apo format e aplikimit të sistemeve në turizëm, vetëm njohuri bazike.</p> <p>Njohuritë në shkencat humane, sociale dhe komunikimit jepen përmes disa lëndëve, si Hyrje në sociologji, Komunikim ndërkulturor, Sjellje organizative, sjellje konsumatore, etj, baza e aftësimit në këto aspekte është shumë e mire edhe për shkak të aplikimit të rasteve praktike dhe diskutimeve të cilat evidentohen si nga syllabuset ashtu edhe nga takimi me pedagogët dhe studentët e programit.</p> <p><i>Plani mësimor i programit të studimit (Ref. nr 14.1)</i></p> <p><i>Syllabuset e lëndëve (Ref. nr 19.1)</i></p> <p><i>Vizita në institucion takimi me pedagogët e programit</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u jape studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale, duke garantuar realizimin në praktikë të marrëveshjeve me punëdhënësit e aktorët e biznesit në përfitim të formimit praktik të studentëve. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar formimin cilësor dhe për të nxitur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>UET ka një traditë të mirë në krijimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit me aktorët e biznesit. Në radhë të parë në këtë program studimi evidentohet se ka lindur si nevojë e bizneseve për burime njerëzore të kualifikuara, në fushën e turizmit, si agjenci dhe tur-operatorë të mëdhenj dhe më tej janë zhvilluar edhe disa takime me biznese të ndryshme përfshirë edhe ato në fushën e turizmit. Aktualisht në kushtet e pandemisë, nuk mund të evidentojmë aplikimin e njohurive në kushte të laboratorëve, por sic u tha edhe më lart, ka vetëm laboratorë ku mund të aplikohen njohuritë e përgjithshme të teknologjisë dhe jo aspekte të veçanta të lidhura me fushën e turizmit, kur në fakt ka shumë Software apo aplikacione specifike të fushës që mund të përdoren. Nga ana tjetër marrëveshjet me operatorë mund të shërbejnë shumë mirë për të testuar njohuritë e marra përmes orëve të vizitave (të cilat mungojnë në syllabuse) në cdo lëndë dhe jo vetëm duke u bazuar tek praktika mësimore. Shtrirja e praktikës vetëm në një semester në fund të studimit gjithashtu e përqendron vëmendjen në 4 semestra në teori dhe raste studimore, por një shtrirje ndryshe mund të ishte dhe një qasje diferencuese e diplomës profesionale.</p> <p><i>Marrëveshjet e bashkëpunimit</i></p>

	<p><i>Plani mësimor i programit të studimit (Ref. nr 14.1)</i></p> <p><i>Syllabuset e lëndëve (Ref. nr 19.1)</i></p> <p><i>Vizita në institucion takimi me pedagogët e programit</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Në përfundim të çdo moduli apo lënde, personeli akademik vlerëson, analizon e shqyrton kompetencat dhe aftësitë e fituara nga studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, duke nxjerrë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orientojnë studentët për implementimin e tyre.</p>	<p>Vlerësimi i arritjeve dhe kompetencave të studentit realizohet sipas rregullores përmes vlerësimit të vazhduar dhe vlersimit përfundimtar. Analizat e rezultateve bëhen në nivel lënde dhe departamenti duke nxjerrë përfundime lidhur me përmirësime të caktuara që duhet të ndërmerren në vijimësi. Format aktuale të vlerësimit të studentëve kanë feedback pozitiv nga vetë studentët.</p> <p><i>Rregullore e programit të studimit (ref. nr 7)</i></p> <p><i>Syllabuset e lëndëve (Ref. nr 19.1)</i></p> <p><i>Vizita në institucion takimi me studentët e programit</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni harton procedura të posaçme, të njohura e publike për diplomimin e studentëve dhe garanton mbështetjen dhe udhëzimin e studentëve në procesin e diplomimit. Ai mban regjistra zyrtarë të studentëve të diplomuar dhe i përditëson ata në fund të çdo viti akademik.</p>	<p>Në bazë të rregulloreve të institucionit dhe programit përshkruhet zhvillimi i procesit të diplomimit të studentëve të programit DP në Turizëm. Për t'u diplomuar studenti duhet t'i nënshtrohet një provim formimi, ose të mbrojë një projekt profesional, i cili të lidhet ngushtë me tematikën që mbulon programi i studimit dhe është një punim i lidhur me praktikën e sektorit. Departamenti përcakton kriteret dhe standartet e hartimit të këtij projekti dhe informon studentët për procedurat dhe kriteret e kalimit të provimit të formimit ose projektit.</p> <p><i>Rregullore e programit të studimit (ref. nr 7)</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Njësia përgjegjëse, personeli akademik dhe udhëheqësit akademikë orientojnë dhe ndihmojnë studentët për përgatitjen e punimit të diplomës, realizimin e veprimtarisë praktike dhe përpunimit të rezultateve, duke garantuar bashkëpunimin edhe me aktorë të jashtëm për realizimin e saj.</p>	<p>Lidhur me praktikën mësimore, ajo mbikqyert nga drejtuesi i departamentit në bashkëpunim me zyrën e karrierës. Zhvillimi i praktikës gjithashtu rregullohet përmes rregullores së vecantë. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e projektit praktik sipas fushave të kërkimit që mbulon departamenti. Studentët udhëzohen nëpërmjet seancave metodologjike dhe sipas një kalendari takimesh të shpallur, duke i ofruar atyre ndihmë lidhur me informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme, nëpërmjet koordinatorit të programit. Sa i përket materialeve të provimit të formimit edhe ato jepen bazuar mbi procedurat përkatëse, nëpërmjet LMS dhe komunikimit me studentët.</p> <p><i>Rregullore e programit të studimit (ref. nr 7)</i></p> <p><i>Rregullore e praktikës</i></p> <p><i>Urdher administrativ "mbi zbatimin e plotë të procesit mësimor"</i></p>

	<i>administrative të platformës UET - LMS (Ref. nr. 46.1)</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

#### IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT DHE MBËSHTETJA E STUDENTËVE

##### Standardi IV.1

**Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për përzgjedhjen dhe cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efçente dhe efektive nga ana e tyre**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton procedura dhe kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura, që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të tij.	Referuar <i>rregullores për Burimet njerëzore pika G.I</i> , UET ka parashikuar procedurat për rekrutimin e personelit. Drejtoria e Burimeve Njerëzore ndjek gjithë procedurat për plotësimin e vendeve vakante në strukturë me rekrutimet. Procedura e verifikuar nga dokumentacionet mbështetëse dhe nga vizita në terren përfshin disa hapa të rëndësishme që nga shpallja e vendit vakant, vendosja e kriterëve të pranimit në përputhje me kërkesat për realizimin e ngarkesës mësimore dhe punës kërkimore shkencore, ngritja e komisioneve, vlerësimi i dosjeve, zhvillimi i konkursit, informacioni përfundimtar dhe vendimi i emërimit. Edhe personeli akademik me kohë të pjesshme i nënshtrohet procesit, përvec pjesës së intervistës. Shpallja e vendit vakant bëhet përmes faqes së Eëb dhe cdo kërkesë, pyetje apo komunikim bëhet gjithashtu përmes e-mailit zyrtar të vendosur në Eëbsite. Për këtë program studimi nuk ka patur rekrutim pasi ka vijuar punën me stafin aktual të brendshëm dhe të jashtëm për të gjitha lëndët.  <i>Statuti UET (Ref. nr. 2)</i> <i>Brishura Dokumenta në zbatim të statutit: Burime njerëzore pikat G dhe I (Ref. nr. 11)</i>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni mbledh, ruan	Dokumentacioni lidhur me personelin e institucionit,


Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program, personin përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtarit në çdo semestër dhe vit akademik, përfshirë tutorët apo vëzhguesit e praktikës në institucionet partnere, si dhe atë të personelit ndihmësmësimit-shkencor dhe administrativ të angazhuar.</p>	<p>përfshirë personelin akademik efektiv dhe atë me kohë të pjesshme ruhet dhe përditësohet nga Zyra e Burimeve Njerëzore, e cila ruan Dosjen Individuale të Stafit Akademik. Drejtorja e Burimeve njerëzore menaxhon dosjet personale të të gjithë punonjësve, dokumentacionin personal të cdo punonjësi, librezën e punës dhe ndryshimet në dosje për shkak të zhvillimit të karrierës dëshmitë e kualifikimeve të mëtejshme të stafit. Nga vizita në institucion me drejtues të zyrës së burimeve njerëzore, u evidentua mbajtja e të dhënave dhe dosjeve me të gjithë elementët, duke bërë një përzgjedhje me dy anëtarë të stafit dhe u pa saktësia e mbajtjes së informacionit për stafin. Zyra e Burimeve Njerëzore evidenton edhe realizimin e ngarkesës mësimore nga stafi në cdo semestër.</p> <p><i>Broshura Dokumenta në zbatim të statutit: Burime njerëzore pikat G dhe I (Ref. nr. 11)</i></p> <p><i>Vizita në institucion zyra e burimeve njerëzore</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimit me karakter profesional dhe për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p>	<p>Krijimi i mjedisit dhe mundësive të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit, përfaqësohet nga nivelet drejtuese të institucionit në përgjithësi dhe nga nivelet drejtuese të departamentit në vecanti. Në të gjitha dokumentet strategjike bazë, Statuti, Strategjia rregullorja e UET, shprehet garancia për lirinë akademike të pedagogut dhe për cilësinë e lartë në proceset akademike dhe infrastrukturë së institucionit, krijimin e një mjedisi nxitës, bashkëpunues dhe zhvillues për profesoratin, studentët dhe stafin e UET. Institucioni gjithashtu anagazhohet për vlerësimin e drejtë të stafit akademik, duke bazuar veprimtarinë në matjen e performances. Informimi është gjithashtu shumë i rëndësishëm lidhur me mundësitë që ofrohen në UET për projekte, kërkim shkencor dhe zhvillim, që krijojnë barazi dhe oportunitete të njëjta për studentët dhe personelin</p> <p>Referuar dokumentit <i>(Aneks 23.1. cilesia e stafit mesimdhënes per programin e studimit, tabelat 6.1, 6.2, dhe 6.3)</i>, të dhënat për stafin e angazhuar në mesimdhënie për këtë program studimi për gjatë tre viteve akademike janë si më poshtë:</p> <p>Për vitin akademik <b>2020-2021</b> janë të angazhuar <b>10</b> pedagogë gjithsej, ndër të cilët <b>9 PAE</b>, nga ku <b>6</b> me tituj/grada dhe <b>1 PAK</b> me grad.</p> <p>Mbulimi i programit në përqindje është <b>90% PAE dhe 10%</b></p>

	<p><b>PAK.</b></p> <p>Për vitin akademik <b>2019-2020</b> janë të angazhuar <b>17</b> pedagogë gjithsej, ndër të cilët <b>16 PAE</b>, nga ku <b>11</b> me tituj/grada dhe <b>1 PAK</b>.</p> <p>Mbulimi i programit në përqindje është <b>94% nga PAE dhe 6% PAK</b>.</p> <p>Për vitin akademik <b>2018-2019</b> janë të angazhuar <b>14</b> pedagogë gjithsej, ndër të cilët <b>13 PAE</b>, nga ku <b>6</b> me tituj/grada dhe <b>1 PAK me titull</b>.</p> <p>Mbulimi i programit në përqindje është <b>93% nga PAE dhe 7% PAK</b>.</p> <p><i>Statuti UET (Ref. nr. 2)</i></p> <p><i>Rregullorja UET (Ref. nr 5)</i></p> <p><i>Broshura Dokumenta në zbatim të statutit: Burime njerëzore (Ref. nr. 11)</i></p> <p><i>Kontratat me personelin akademi të brendshëm dhe të jashtëm si dhe shtesat përkatëse ( Ref. Nr 24.1 dhe 24.2)</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit, përmes organizimit të programeve specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, si dhe mbështetjen për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>Personeli që mbulon programin e studimit kualifikohet dhe zhvillohet në mënyrë të vazhdueshme. Burimet njerëzore kanë mundësi për tu zhvilluar dhe certifikuar në aspektet e mësimdhënies, kërkimit shkencor, drejtimit dhe menaxhimit dhe komunikimit publik. UET duke u bazuar tek grantet e vëna në dispozicion për kërkimin shkencor mbulon shpenzimet për pjesëmarrjen në konferenca dhe trajnime në vend dhe jashtë vendit. Gjithashtu qendra e metodologjisë kujdeset për trainime të ndryshme të pedagogëve, si në përgjithësi ashtu edhe në raste të vecanta, kur paraqitet nevoja. Për zhvillimin e karrierës marrin më tepër rëndësi momentalisht programet Erasmus+, të cilat ofrojnë shkëmbime dhe trainime të stafit në institucionet e huaja të Arsimit të lartë. Si rrjedhim i kësaj mbështetjeje por sidomos edhe bazuar mbi kërkesën e vazhdueshme të vetë stafit për kualifikime, evidentohen disa raste të rritjes dhe zhvillimit të karrierës së pedagogëve.</p> <p><i>Rregullore UET ( ref. Nr 5)</i></p> <p><i>Broshura Dokumenta në zbatim të statutit: Burime njerëzore (Ref. nr. 11)</i></p> <p><i>Vizita në institucion tamimi me drejtues të zyrës së kërkimit shkencor</i></p>
<p><b>Shkalla e përbushjes së</b></p>	<p><b>Nuk</b>      <b>Përbushet</b>      <b>Përbushet</b>      <b>Përbushet</b></p>



standardit	përmbyshet	pjesërisht	kryesisht	plotësisht
				X

<b>Standardi IV.2</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të përshtatshëm sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit me karakter profesional</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Mjediset fizike përbëhen nga salla leksionesh seminaresh dhe laboratorë për zhvillimin e leksioneve dhe seminareve të programit. Numri i sallave në dispozicion dhe hapësirat përkatëse janë të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore. Ka gjithashtu mjedise të tjera si salla për praktikën e lëndëve/ praktikën profesionale, salla për veprimtari promovuese, innolab, zyra e informacionit për studentët, etj. Studentët dhe pedagogët kanë akses në mjediset e bibliotekës, ku ka hapësira të bollshme, 150 vende dhe kompjutera në dispozicion. Mjediset janë të pajisura me systemin ngrohje-ftohje duke garantuar kushtet e duhura për procesin.  <i>Vizita në institucion</i> <i>Infrastruktura në dispozicion të programit të studimit (Ref nr. 42)</i>
<b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore, si: klasat, laboratorët, studiot e mjediset e tjera janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Çdo sallë e leksioneve është pajisur me mjete audiovizive, projektorë dhe foni. Për cdo leksion mundësohet prezantimi PPT. Laboratorët janë të pajisur me një numër të konsiderueshëm kompjuterash duke patur parasysh grupet e studentëve. Situata është e kenaqshme për realizimin e orëve mësimore lidhur me teknologjinë sa u përket pajisjeve dhe infrastrukturës.  <i>Infrastruktura në dispozicion të programit të studimit (Ref nr. 42)</i> <i>Vizita në institucion</i>
<b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas fushës specifike të programit profesional, përbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të	Sipas vizitës në institucion u pa se laboratorët janë të përshtatshëm për realizimin e orëve në raste të nevojshme për programin e studimit. Nuk ka akses në programe të cilat mund të shërbejnë specifikisht degës së turizmit të cilat janë të nevojshme për aftësimin e studentëve në tregun e punës, por duhet thënë se për programin duhet të kombinohet në të ardhmen mundësia e përfshirjes së këtyre programeve me

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al

programit të studimit në tërësi.	lëndë të caktuara të cilat mund jenë aktualisht ose të futen rishtazi në program. <i>Infrastruktura në dispozicion të programit të studimit (Ref nr. 42)</i> <i>Vizita në institucion</i>			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/eve të studimit që ofron.	UET ka më shumë se një laborator të teknologjisë së informacionit dhe gjithashtu ka inaguaruar dhe ka vënë në funksion më parë sallën e re InnoLab, pjesë e projektit Innovation Hub, e cila mund tu shërbejë edhe studentëve të degës së turizmit në raste të vecanta. Aktualisht nuk ka Software profesionale për programin e studimit dhe programi nuk është ndërtuar për të përfutuar aktivitete në laborator dhe nuk ka programe profesionale që mund të përdoren, pasi nuk parashikon ngarkesë me orë laboratorike, por InnoLab është një hapësirë e mundshme për disa aktivitete të tilla në mënyrë të kufizuar. <i>Infrastruktura në dispozicion të programit të studimit (Ref nr. 42)</i> <i>Vizita në institucion</i>			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale, internship-it dhe veprimtarive të tjera praktike thelbësore për programet me karakter profesional.	Zhvillimi i praktikave profesionale realizohet sipas një procedure të qartë të përmendur në rregulloren e programit dhe rregulloret përkatëse dhe që garanton realizimin e praktikës mësimore në mjediset e kompanive/organizatave përkatëse. Për këtë realizohet një marrëveshje e qartë me institucionet që i garanton studentit vendosjen në mjediset e kompanive/organizatave përgjatë gjithë periudhës së praktikës. Institucioni dhe departamenti është përgjegjës për pjesën e praktikës në auditor ku për rastin e programit të studimit në fjalë realizohen 8 orë gjithsej përgjatë 4 javëve. <i>Rregullore e programit të studimit</i> <i>Marrëveshjet e bashkëpunimit me institucione homologe brenda e jashtë vendit (Ref. nr 34)</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			<b>X</b>	

### Standardi IV.3

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse e të posaçme të mësimnxënies, bibliotekën e literaturën dhe mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit dhe realizimin cilësor të tij**





Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit dhe krijon kushte për akses të barabartë e pa pagesë dhe të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p> <p><b>Kriteri 2.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë mësimore bazë, ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, të mjaftueshme dhe të përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Sic u përmend edhe në Standartin III.2 dhe III.3, duke qenë se biblioteka është pjesë përbërëse e mjediseve të UET, mundësitë e shfrytëzimit të bibliotekës janë të barabarta për të gjithë studentët. Frekuentimi i bibliotekës nga studentët në vitin pandemik kuptohet që ka rënë për shkak të rregullave andicovid, por secili sigutrisht ka të drejtë të shfrytëzojë në vijimësi të gjitha mjediset e saj, në kushte normale.</p> <p>Biblioteka përmban gjithë literaturën e nevojshme dhe të domosdoshme të lidhur me programin e studimit. Gjithë literaturat në formën e librave dhe revistave në gjuhën shqipe dhe të huaj janë të kategorizuara sipas standarteve të bibliotekave, ka punonjës të trainuar lidhur me organizimin dhe menaxhimin e bibliotekave.</p> <p><i>Numri i titujve është i kufizuar në bibliotekën e UET, tek tituj në Shqip për programin e studimit.</i></p> <p>Numri i titujve në anglisht për programin e studimit është i kënaqshëm, por duke patur parasysh nivelin e diplomës profesionale, duhet fokusuar sidomos në titujt në Shqip për lëndët karakterizuese dhe lëndët bazë.</p> <p>Një përditim me literaturat më të fundit realizohet përmes abonimit në platformat elektronike, ku ka akses në rrjetin e bibliotekave sipas sistemit COBIS, si edhe aksesin në bibliotekat online. Gjatë vizitës në bibliotekë u provua aksesin në këto sisteme online dhe u verifikua infrastruktura e bibliotekës, ndaj mund të vlerësojmë se ka përshtatshmëri me veprimtaritë mësimore sipas natyrës së programit.</p> <p><i>Formular për pasurimin e fondit të librave në bibliotekë (ref nr 45.2)</i></p> <p><i>Infrastruktura në dispozicion të programit të studimit (Ref nr. 42)</i></p> <p><i>Vizita në institucion në bibliotekë</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit dhe duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	<p>Sic u përmend më sipër Biblioteka e UET u jep mundësi të gjithë studentëve të aksesojnë në bibliotekat online pa pagesë, përmes kompjuterave desktop të vendosur aty.</p> <p>Programet kompjuterike dhe pajisjet teknike, shërbimi EIFI janë në nivele të kënaqshme në përgjithësi dhe në dispozicion të programit të studimit për të gjithë studentët pa kufizime.</p> <p><i>Shembull procedure blerjeje literature (ref. nr. 45.3)</i></p>




	<p><i>Infrastruktura në dispozicion të programit të studimit (Ref nr. 42)</i></p> <p><i>Vizita në institucion në bibliotekë</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, përmes bashkëpunimit me aktorë të jashtëm, të angazhuar në realizimin e programit mësimor, duhet t'u lehtësojnë dhe garantojë studentëve mbështetjen dhe përdorimin e burimeve e logjistikës së nevojshme të institucioneve partnere, në varësi të natyrës së angazhimit të tyre në procesin formues teorik, praktik dhe profesional të studentëve.</p>	<p>Ky kriter mund të aplikohet në rastin e programit në bashkëpunimin me partnerët për programet e praktikave mësimore si edhe në rastet e bashkëpunimit me partner në projekte kombëtare e ndërkombëtare. Institucioni ofron mundësi për mbështetje të studentëve në përdorimin e logjistikës së jashtme të institucioneve partnere përmes marrëveshjeve që realizon me ta. Konkretisht për programin e studimit kjo praktikë do të duhet të ndiqet për të ardhmen për shkak të problemeve gjatë vitit pandemik. Por ekzistojnë kushtet për tu realizuar.</p> <p><i>Parimet e organizimit të zyrës së projekteve dhe partneriteteve (Ref. nr. 43.1)</i></p> <p><i>Lista e subjekteve dhe institucioneve bashkëpunuese (ref.nr 32)</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni parashikon koston financiare të programit të studimit profesional, mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi dhe raportin financiar të përvitshëm dhe në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi.</p>	<p>Ligji i arsimit të lartë 80/2015 krijon gjithë hapësirat ligjore për ndërtimin e mekanizmave të duhur për menaxhimin financiar të institucionit dhe pjesëve përbërëse të tij. Menaxhimi financiar është një komponent themelor i mbarëvajtjes së institucionit. Lidhur me programin e studimit, referuar RVB konsiderohet praktikisht e pamundur hartimi i raporteve në bazë program studimi. Burimi kryesor i të ardhurave janë tarifatat e studimit.</p> <p><i>GVJ gjykon se duhet të ketë një plan të mbështetjes financiare i cili duhet të përfshijë parashikimin për burimet e të ardhurave të vetë programit dhe sponsorizime apo përfshirje në projekte të mundshme, të cilat të mbështesin kostot e programit të studimit. Sygjerohet një punë e shërbimeve mbështetëse të zyrës së financës lidhur me një analizë mbi bazë program që pastaj të realizohet edhe për këtë program.</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Financimi i një programi studimi profesional duhet të sigurojë e të garantojë mbulimin e të gjitha burimeve dhe veprimtarive të qëndrueshme dhe operative, të lidhura e që janë në funksion të realizimit të programit të studimit, duke garantuar njëkohësisht qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit e në vijim.</p>	<p>Në nivel institucioni realizohet një plan financiar në kuadër të planit strategjik të institucionit. Pasqyrat financiare hartohen sipas ligjit dhe paraqesin kontabilizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve. Duke qenë se shumë aktivitete të procesit të mësimdhënies realizohen duke grupuar student dhe kurse aty ku ka mundësi bazuar mbi lëndët e programeve, vlerësohet se garantohej një optimizim i kostove për njësi. Sidoqoftë analizat financiare nuk paraqesin detaje të programit të studimit për arsye të sipërpërmendura në kriterin 5.</p>

	<i>Takim me pedagogët e programit</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

#### Standardi IV.4

**Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek, zbaton politika e procedura institucionale dhe i jep formacion të plotë e të hollësishëm studentëve mbi programin e studimit me karakter profesional, pranimin, përzgjedhjen, përparimin akademik, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton, zbaton dhe bën publike politika, procedura e kriteret të qarta e të kuptueshme për pranimit e studentëve, përparimin e tyre përgjatë kursit të studimit, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit, të cilat garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>UET ka hartuar dhe vënë në zbatim politika dhe procedura që mbulojnë në mënyrë të plotë ciklin e studimeve të diplomës profesionale universitare në përputhje me legjislacionin në fuqi. Programi i studimit ka përcaktuar qartë objektivat që lejojnë formimin e studentëve duke zhvilluar njohuri, aftësi dhe kopetenca profesionale e analitike. Kriteret e pranimit të studentëve përcaktohen në përputhje me udhëzimet dhe kuotat e përcaktuara në aktet nënligjore për vitin akademik përkatës. Ato përcaktohen dhe në rregulloren e programit të studimit pika 2 dhe krijojnë kushte të barabarta për të gjithë studentët për të aplikuar për programin sipas kriterëve.</p> <p>Rregullorja e Programit të studimit përmban në mënyrë të detajuar (pika 3 dhe 5) procedurat dhe praktikat e trajtimit të studentëve që nga momenti i regjistrimit, vlerësimit të dijeve dhe deri në përfundim të studimeve diplomim apo transferimin e tyre, gjë që garanton politika dhe procedura transparente për trajtim të barabartë të të gjithë kandidatëve dhe studentëve të programit.</p> <p><i>Rregullore Programi i Studimit (Ref. nr 7)</i> <i>Rregullore e UET ( Ref. Nr. 5)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të përgjithshme dhe/ose të veçanta për pranimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve në programet e studimit me karakter profesional dhe udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me to.</p>	<p>Sa i përket kriterëve të pranimit në këtë program specifik studimit, nuk janë vendosur gjatë vitit të kaluar kriteret të vecanta për pranimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve, pasi kjo nuk është gjykuar si efektive. Por të gjitha kriteret e pranimit të cilat janë të shprehura në rregulloren e programit, janë publikuar me hapjen e regjistrimeve për programin dhe publikohen vazhdimisht në faqen e Eëb-it të UET.</p>



	<p><i>Rregullore Programi i Studimit (Ref. nr 7)</i>  <a href="http://www.uet.edu.al">www.uet.edu.al</a></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përpërimit akademik të studentëve, zhvillimin e veprimtarive praktike e profesionale të programit dhe institucionet bashkëpunuese në këto veprimtari, vlerësimet të dijeve e aftësive të studentëve dhe diplomimit.</p>	<p>Kriteret dhe procedurat e përpërimit akademik gjenden në rregulloren e programit të studimit, ku janë të shprehura kushtet dhe kreditet e kalimit nga një vit në tjetrin, procedurat e zhvillimit të praktikës, kriteret për diplomimin e studentëve. Gjatë zhvillimit të programit, për studentët vihet në dispozicion informacion i duhur përmes LMS dhe kooordinatorit të programit për institucionet për realizimin e praktikës, apo ku UET ka bashkëpunim, mënyrat si do vlerësohen dijet për cdo lëndë edhe nëpërmjet syllabuseve.</p> <p><i>Rregullore Programi i Studimit (Ref. nr 7)</i>  <a href="http://www.uet.edu.al">www.uet.edu.al</a></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin, kohëzgjatjen e programit të studimeve, mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Struktura, organizimi dhe kohëzgjatja e programit të studimit është pjesë e rregullores së programit me të cilët studentët njihen sapo fillojnë studime. Java e parë është javë orientuese në UET, ku studentët informohen për mundësitë e programit. Gjithashtu studentët janë informuar për këtë program studimi konkret DP në turizëm edhe nga zyra e karrierës dhe gjithashtu nga koordinatori i programit janë vënë në dispozicion gjithë informacionet e nevojshme. Studentët janë informuar për mundësitë e punësimit edhe përgjatë zhvillimit të lëndëve të ndryshme si dhe përgjatë leksioneve të hapura në nivel program dhe në nivel universiteti.</p> <p><i>Rregullore Programi i Studimit (Ref. nr 7)</i>  <i>Vizita në institucion: Takimi me studentët e programit</i>  <i>Vizita në institucion: Takimi me zyrën e karrierës</i>  <i>Vizita në institucion: Takimi me shefin e departamentit</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen, veprimtaritë formuese dhe informacion të gjerë e të përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>UET përmes rregullores së UET dhe rregullores së programit të studimit, jep informacion për studentët. Lëndët dhe modulet janë të vendosura në ëeb-site dhe janë transparente për studentët. Gjithashtu zhvillimi dhe organizimi i procesit mësimor dhe informacionet mbi logjistikën, infrastrukturën jepen edhe përmes LMS.</p> <p><i>UET LMS guidë për studentët (Ref nr 46.3)</i>  <i>Rregullore e UET ( Ref. Nr. 5)</i>  <i>Rregullore Programi i Studimit (Ref. nr 7)</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet</p>	<p>Studentët kanë marrë gjithë informacionin e duhur për programin, pavarësisht një viti të vështirë sic ishte viti</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	akademik që sapo kaloi për shkak të pandemisë COVID 19. Nga evidentimi i sistemit dhe takimi me studentët e programit u pa se të gjitha informacionet që ata kanë nevojë i kanë lehtësisht të arritshme përmes dy sistemeve LMS dhe TEAMS.  <i>UET LMS guidë për studentët (Ref nr 46.3)</i>  <i>Vizita në institucion: Takimi me studentët e programit</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

#### Standardi IV.5

**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit me karakter profesional**

Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomimin e daljen në tregun e punës.	<p>UET disponon një sistem të brendshëm për menaxhimin e informacionit. Ky sistem përbëhet nga dy sisteme LMS dhe sistemi zyrtar UMIS. I pari është në shërbim primar të studentëve me synim kryesor rritjen e cilësisë së shërbimit të tyre në çdo hallkë të procesit dhe sigurisht në këtë kontekst edhe të stafit pedagogjik, mësimor kërkimor dhe stafit administrativ. Përmes sistemit UMIS mirëmenaxhohet procesi administrativ, institucional, sidomos për databazën e studentëve, vlerësimet notat dhe mbështetjen e punës së sekretarive mësimore. Sipas sekretarisë mësimore dy pjesët nuk janë të lidhura për sa i përket shkëmbimit të informacionit për vlerësimet me pikë dhe notat. Pjesa e sistemit LMS për studentët dhe pedagogët ofron shërbimin përmes llogarive log in përkatëse, ku vendoset gjithë informacioni dhe merret nga studentët.</p> <p><i>UET – LMS guidë për studentët (Ref. Nr 46.2)</i> <i>UET – LMS trainim për sistemin për pedagogët (Ref. Nr 46.1)</i> <i>Vizita në institucion, shikimi i mjediseve dhe infrastrukturës dhe takimi me sekretarinë mësimore</i></p>
<b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik,	<p>Sistemi i menaxhimit të informacionit menaxhon informacionin lidhur me personelin akademik që lidhet kryesisht me syllabuset, programet, mësimdhënien dhe lidhjen me faqen e pedagogut.</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al

personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe të partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	<i>UET – LMS trainim për sistemin për pedagogët (Ref. Nr 46.1)</i> <i>Vizita në Institucion takimi me pedagogët</i>			
<b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit. <b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.	Aksesi i dedikuar në informacionin e LMS është i garantuar përmes username dhe passWord për secilin pedagog dhe për secilin student. (procesi u shpjegua më lart). Çdo hap i procesit mësimor paraqitet me informacion të ofruar nga UMS, nëpërmjet bazës së të dhënave “ <i>Dokumenta UET</i> ”, ndërsa studentët kanë akses mbi informacionin e programit të studimit për lëndët përkatëse siç regjistrohen në platformën LMS. Përmes platformës aktuale mundësohet edhe Komunikimi interaktiv midis pedagogëve dhe studentëve, që gjithashtu komunikojnë edhe përmes e-mailit zyrtar UET.			
<b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.	Sistemi LMS garanton monitorim dhe ndjekje të përdorimit të sistemit nga pedagogët dhe studentët si dhe raportim të performancës së studentëve, respektimin e afateve të pedagogëve, lidhur me detyrat, vlerësimet, hedhjen në sistem të informacioneve të tjera dhe gjenerimin e aksesimit në kohë reale. Platforma LMS është një mjet që përdoret edhe nga Komisioni i Sigurimit të Brëndshëm të Cilësisë, pasi me anë të tij mund të monitorohet dhe mbarëvajtja e të gjithë procesit akademik. <i>Vizita në institucion takimi me NJSBC</i>			
<b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik dhe aktivitetet e ndryshme publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Duke parë Eëb-site të UET vëmë re se ky kriter përmbushet pasi ka një informacion mbi programet e studimit, stafin akademik të programit CV-të e stafit dhe aktivitetet që realizon UET. Informacioni është i përkthyer plotësisht dhe i vendosur në dy gjuhë. <i>Faqja e Internetit <a href="http://www.uet.edu.al">www.uet.edu.al</a></i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardevë të fushës IV</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>	

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

<b>Standardi V.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin, në programin e studimit dhe i vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika, procedura dhe kritere të pranimit, përparimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit të studentëve, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore dhe që janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Kriteret dhe procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë ndjekjes së programit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit përcaktohen qartë në rregulloren e programit të studimit dhe rregulloren e UET. UET bën public gjithë informacionet e nevojshme nëpërmjet faqes zyrtare duke e bërë lehtësisht të aksesueshëm për publikun.</p> <p><i>Rregullore Programi i Studimit (Ref. nr 7)</i>  <i>Të dhëna nga faja zyrtare e ëeb-it ( ref nr 47)</i>  <a href="http://www.uet.edu.al">www.uet.edu.al</a></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje dhe orientimin drejt tregut të punës, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>UET arrin përmes procedurave dhe politikave të ndërtuara për studentët gjatë gjithë procesit akademik të garantojë barazine dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentët (në hyrje) dhe studentët e programit të studimit. Kështu përmendim vendosjen e kritereve të drejta, procedura të sekretimit apo ankimimit dhe ngritjes së komisioneve, apo rastin e urdhërit të rektorit për vlerësimin e detyrave dhe provimeve për studentët me aftësi të kufizuara.</p> <p><i>Rregullore e UET (Ref. nr. 5)</i>  <i>Urdhër i rektorit “Mbi vlerësimin e detyrave të kursit dhe provimeve për studentët me aftësi shikimi të kufizuar”. Ref. nr 5.2)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve dhe, përpara fillimit të çdo viti akademik, udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kritereve të përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Në rregulloren e programit përcaktohen kritere të përgjithshme për pranimin në programin DP turizëm dhe thuhet se departamenti mund të përcaktojë kritere të veçanta. Në këtë rast gjatë vitit akademik të kaluar nuk ka patur kritere të veçanta. Publiku udhëzohet mbi kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve përmes faqes së Internetit përpara fillimit të vitit akademik dhe përmes zyrës së karreirës dhe koordinatorëve të cilët gjithashtu</p> <p><i>Rregullore Programi i Studimit (Ref. nr 7)</i>  <i>Dokumentacioni I kërkuar për regjistrim ( ref. nr 27. 1)</i></p>

	<i>Takimi me zyrën e karrierës</i>			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve, kalimit nga një vit akademik në tjetrin, procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Informacioni lidhur me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve, transferimeve studimeve të pjesshme është i plotë përmes rregullores së UET dhe rregullores së programit të studimit.  <i>Rregullore e UET (ref. nr 5)</i> <i>Rregullore Programi i Studimit (Ref. nr 7)</i>			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit dhe diplomimit në programin e studimit.	Informacioni mbi kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve dhe diplomim jepet gjatë javës informuese në fillim të vitit akademik si dhe gjatë periudhës së realizimit të studimeve, përmes syllabuseve të lëndëve të vendosura në LMS dhe TEAMS apo përmes orëve orientuese për praktikat dhe diplomimit.  <i>Rregullore Programi i Studimit (Ref. nr 7)</i> <i>Syllabuset e lëndëve</i>			
<b>Kriteri 6.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	UET organizon takime me gjimnazistët studentët potencialë përmes tureve në gjimnaze, shpërndan broshura dhe informacion në faqen e Internetit për informimin e të interesuarve për tu regjistruar pranë UET. Në këtë program studimi janë bërë përpjekje maksimale nëpërmjet zyrës së karrierës për të orientuar studentët të cilët kanë ardhur me ide jo shumë të qarta, në mënyrë që të zgjedhin DP në turizëm në varësi të aftësive të tyre.  <i>Vizita në institucion: Takim me zyrën e karrierës</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### Standardi V.2

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit**

Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni informon në mënyrë të hollësishme studentët për strukturën, organizimin dhe	Informacion i hollësishëm në lidhje me kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimin nga një vit akademik në tjetrin paraqitet qartë në rregulloren e UET si dhe



<p>kohëzgjatjen e programit të studimeve dhe ve në dispozicion të tyre, informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese të programit të studimit me karakter profesional.</p>	<p>atë të programit të studimit. Ky informacion vihet në dispozicion nga zyra e pranimeve, zyra e këshillimit të karrierës dhe sekretaria e institucionit.</p> <p><i>Rregullore e UET ( ref. nr 5)</i>  <i>Rregullore Programi i Studimit (Ref. nr 7)</i>  <i>Vizita në institucion: Takim me zyrën e karrierës</i></p>			
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët mbi praktikat profesionale në kuadër të realizimit të programit të studimit, partnerët dhe institucionet bashkëpunuese ku parashikohen të realizohen, si dhe mundësitë e punësimit e mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.</p>	<p>Informacioni mbi praktikat profesionale, partnerët dhe institucionet bashkëpunuese jepet nepërmjet departamentit dhe koordinatorit të programit të studimit si dhe nga pedagogët, departamenti në takime të ndryshme me guest speaker apodhe nga zyra e karrierës.</p> <p><i>Vizita në institucion: Takim me zyrën e karrierës</i>  <i>Vizita në institucion: Takim me studentët</i></p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut informon studentët në lidhje me strukturën, organizimin dhe logjistikën infrastrukturën dhe shërbimet, nepërmjet rregullores së programit të studimit dhe nepërmjet komunikimeve të vazhdueshme me studentët përmes koordinatorit të programit. Informacion i gjerë dhe i përdituar vendoset në dispozicion të studentëve në Eëbsitin e UET dhe u lejon studentëve për të marrë informacion lidhur me organizimin e plotë të studimeve të këtij programi. Gjithashtu, studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe shërbimet e ofruara nga zyra e pranimeve, zyra e këshillimit të karrierës dhe pedagogët, dhe gjendet i publikuar në sistemin UET LMS ku çdo student është i regjistruar.</p> <p><i>Vizita në institucion: Takim me studentët</i>  <i>UET LMs guida për studentët</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Platformat elektronike të përdorura edhe më përpara pandemisë në UET, por sidomos të zgjeruara dhe shtuar përdorimi i tyre gjatë dy viteve të fundit akademike, japin mundësinë e informimit të studentëve për ta patur atë lehtësisht të arritshëm përmes kompjuter dhe smartphone.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>



**Standardi V.3**

**Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit me karakter profesional, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm**

Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në vitet paraardhëse në programin e studimit.</p>	<p>Statistikat vjetore për numrin e studentëve dhe të diplomuarve mbahen nga departamenti dhe sekretaria mësimore. Në UET është traditë që nëpërmjet Shoqatës Alumni, në mënyrë periodike mbahen kontakte të vazhdueshme dhe me ish-studentë me qëllim ndarjen e eksperiencave dhe arritjeve profesionale të tyre por edhe krijimin e urave efektive lidhëse midis universitetit e tregut të punës. Në rastin e programit duke qenë një program i ri, nuk ka të dhëna momentale për këtë, por ka vijim të traditës dhe nga programet e tjera.</p> <p><i>Të dhëna për diplomimin dhe punësimin e studentëve Tabela 23 pjesë e anekseve të raportit (Ref nr 29)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon dhe ruan statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Sekretaria mësimore në regjistrat mban të dhënat e studentëve të tërhequr nga programi dhe largimet përpara përfundimit. Në rastin e DP turizëm, nuk ka të tillë.</p> <p>Numri i studentëve të regjistruar për herë të parë, për vitet akademike është:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Për vitin akademik 2018-2019 14 studentë;</li> <li>- Për vitin akademik 2019-2020 14 studentë, 1 është c' regjistruar;</li> <li>- Për vitin akademik 2020-2021 3 studentë;</li> </ul> <p><i>Vizita në institucion, takimi me sekretarinë mësimore</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre, përfshirë punësimin eventual të tyre.</p>	<p>Të dhënat për ecurinë, notat e studentëve, studentët kalues dhe jokalues, numrin e provimeve të prapambetura për secilin student, ruhen në sekretarinë mësimore, ku u evidentua një numër i ulët studentësh të programit që kanë kaluar të gjitha provimet sipas planit mësimor. Sa i përket të dhënave mbi punësimin eventual të studentëve këto mbahen nga zyra e karrierës, si pjesë funksionale e detyrave të saj.</p> <p><i>Vizita në institucion, takimi me sekretarinë mësimore</i></p> <p><i>Vizita në institucion, takimi me zyrën e karrierës</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të</p>	<p>Sistemi tradicional i informacionit për të dhënat e studentëve me regjistrat përkatës është siguri që të gjitha të dhënat e studentëve të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme</p>

informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	nga personat e autorizuar. Përdorimi i sistemit UMIS për pjesën e bazës së të dhënave të studentëve lehtëson sigurisht bën më efektive punën me nxjerrjen e dokumentacionit dhe shërbimeve të sekretarisë.  <i>Vizita në institucion, takimi me sekretarinë mësimore</i>								
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe të shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Departamenti harton raportin vjetor të analizës mësimore mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe punësimin e tyre. Departamenti reflekton mbi gjendjen aktuale dhe bazuar në këto të dhëna propozon masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.  <i>Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve tabela 21 anekset e raportit (Ref. nr. 27)</i>								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

#### Standardi V.4

**Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre**

Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.	Studentët kanë mbështetjen e UET për tu angazhuar në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore në fuqi. Bazuar mbi statutin dhe rregulloren e UET studentët organizohen në Këshillin Studentor. Studentët e këtij programi, duke qenë edhe në kohën e mësimit online, por sidomos edhe si rrjedhim i aktiviteteve të tyre të punës, shpesh të lidhura me terrenin e fushës së turizmit nuk kanë patur në vëmendje pjesëmarrjen në organet vendimmarrëse, por janë të informuar. Sipas strukturave në UET studentët marrin pjesë dhe në fokus grupe për vlerësimin e procesit mësimor duke dhënë ide për përmirësime të vazhdueshme në përputhje me nevojat e tyre si dhe në procesin e anketimit për vlerësimin për lëndët dhe pedagogun.  <i>Vizita në institucion, takimi me përgjegjësën e departamentit dhe takimi me studentët</i>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose e përfaqësuesve të tyre në	UET garanton përfshirjen e studentëve në vendimmarrje dhe në këshillim dhe vlerësimin mbi procesin akademik. Studentët

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>organizohen në Këshilla Studentore ku shprehin mendimin e tyre për problematika të ndryshme lidhur me ceshtje të programeve mësimore dhe procesit mësimor. Gjithashtu KSBC organizon cdo muaj focus grupe me studentët, përmes të cilave mendimet dhe propozimet e studentëve u paraqiten departamentit dhe merren masat përkatëse korrigjuese.</p> <p><i>Mbi përfshirjen e studentëve në qeverisjen e UET (Ref. nr. 56)</i></p> <p><i>Vizita në institucion, takimi me studentët</i></p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>Programi i studimit është organizuar duke marrë në konsideratë aftësinë e studentëve për të përvetësuar njohuritë. Në vlerësimin e ngarkesës akademike janë mbajtur në konsideratë si marrja e informacionit teorik ashtu dhe atij praktik përmes detyrave dhe projekteve të kursit. Vlerësimi i studentit realizohet në mënyrë të shpërndarë gjatë semestrit. Kjo formë vlerësimi inkurajon angazhimin e plotë të studentëve gjatë gjithë kursit. Departamenti është bashkëpunues me studentët për të lehtësuar praktikat e plota të njohjes së lëndëve dhe ka procedurë joburokratike të njohjes së studimeve të mëparshme.</p> <p><i>Rregullore Programi i Studimit, pika 9 (Ref. nr 7)</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimin të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Studentët në mënyrë indirekte përfshihen në rishikimin e syllabuseve apo të programit DP Turizëm Kjo për faktin se studentët angazhohen në vlerësimin e performancës së pedagogëve dhe në dobinë e disiplinës akademike përmes pyetësoreve.</p> <p><i>Rregullore Programi i Studimit, (Ref. nr 7)</i></p> <p><i>Vizita në institucion, Takimi me NJSBC detyrimit që kanë studentët të përfshihen në plotësimin e pyetësoreve.</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Studentët përmes Fokus Grupeve dhe Anketimeve të realizuara nga institucioni mund të japin mendimin e tyre mbi kryerjen e procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve Gjithashtu, nga vizita në institucion u informuam se pas çdo provimi organizohen dhe kryhen seancat sqaruese në të cilat studentët kuptojnë dhe komunikojnë me pedagogun përkatës lidhur me vlerësimin dhe mundësinë për rishikim të vlerësimit.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>




**Standardi V.5**

Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët

Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	<p>Në UET, njësitë e informimit për shërbimet ndaj studentëve janë:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>• Departamenti, ku studenti merr informacione mbi organizimin e mësimit, aktivitete të ndryshme, diplomimin, procesin mësimor;</li><li>• Sekretaria mësimore ku studenti merr shërbime, informohet mbi ecurinë dhe progresin e tij në këtë program studimi;</li><li>• Zyra e karrierës ku studentët marrin informacion mbi trajnimet, praktikat dhe ofertat e punësimit;</li></ul> <p>UET ka krijuar procedurë në shërbim të informimit të studentëve në përputhje rregullatoren e institucionit, ky kryesore është edhe java e informimit.</p> <p><i>Rregullore e UET, (Ref. nr 5)</i></p> <p><i>Rregullore Programi i Studimit, (Ref. nr 7)</i></p>
<b>Kriteri 2.</b> Në institucion është ngritur dhe funksionon një sistem i posaçëm për mirëpritjen, informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe ndihmesën e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	<p>UET ka platformën UET LMS si dhe platformën TEAMS gjatë vitit të fundit për informimin, këshillimin, ndjekjen, asistimin e studentëve për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit. UET-LMS dhe TEAMS ofrojnë informacione të përditësuara për procesin mësimor dhe programin e studimit. Baza e të dhënave për studentin përfshin edhe emailin si një mjet për informim dhe këshillim nga zyrat përkatëse dhe kordinatorët. Gjithashtu ka ngritur zyrën e kujdesit ndaj studentëve, ndihmën ndaj tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p> <p><i>Mbi funksionimin e Zyrës së këshillimit të karrierës dhe të kujdesit ndaj studentit ( Ref. nr 12)</i></p>
<b>Kriteri 3.</b> Përmes zyrës/njësisë për këshillimin e karrierës, institucioni mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm lidhur me plotësimin e detyrimeve të	<p>Zyra e karrierës luan rol të rëndësishëm në këshillimin dhe orientimin e studentëve në mënyrë të vazhduar dhe periodike për praktikën profesionale dhe tregun e punës. Përmes panairëve të organizuara, projekteve bashkëpunuese me biznesin, bordin e Alumni, UET shkëmben informacion lidhur me njohuritë dhe aftësitë që ofron programi i studimit</p>

<p>procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>dhe profilet në tregun e punës. Në këtë program studimi kjo zyrë ka luajtur një rol të mirë për të orientuar disa studentë të pasigurt për zgjedhjen lidhur me degën e turizmit, si një dëgë që do të jetë e rëndësishme në vietet e ardhshme për ekonominë Shqiptare.</p> <p><i>Mbi funksionimin e Zyrës së këshillimit të karrierës dhe të kujdesit ndaj studentit ( Ref. nr 12)</i></p> <p><i>Vizita në institucion takimi me zyrën e karrierës</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit, ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse dhe merr masa për përmirësimin e shkallës dhe cilësisë së punësimit të tyre.</p>	<p>Zyra për këshillimin e karrierës dhe Shoqata Alumni ndjekin studentët pas diplomimit duke mbledhur, përpunuar dhe mbajtur të dhëna mbi punësimin e studentëve të të gjitha programeve të studimit. Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut ka bordin e tij të tregut të punës me 11 anëtarë, të cilët sigurojnë informacion dhe ua vënë në dispozicion organeve dhe autoriteteve drejtuese përkatëse, ku ky bord luan rol përvec orientimit lidhur me bizneset në përgjithësi, edhe për fushën e turizmit në vecanti. Gjithashtu për këtë program specifik, duke qenë në fillimet e tij, Zyra e karrierës do të angazhohet më tej për krijimin e bazës së të dhënave Alumni.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>



**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit me karakter profesional në  
“Turizëm”**

**a. Pikat e forta dhe afirmime:**

1. Strukturë e mirëorganizuar e UET lidhur me ofrimin e programit DP turizëm, sa i përket drejtimit dhe organizimit, rregullave, politikave dhe strukturave të departamentit dhe fakultetit, marrëdhënieve institucionale dhe shërbimeve mbështetëse, praktikave të punës së mirëdrejtuar, të gjitha në funksion të programeve ekzistuese, por edhe programeve relativisht të reja si program i DPT;
2. Programi krijon mundësi për të arritur një treg me rëndësi sic është tregu i turizmit përmes specialistëve të ardhshëm, të cilët diplomohen nga një institucion me përvojë dhe eksperiencë si UET;
3. Eksperiencë e stafit akademik të departamentit dhe si rrjedhim edhe të programit në mësimdhënie dhe kërkim shkencor, e cila kontribuon direkt në krijimin e një oferte cilësore për programin;
4. Infrastrukturë e përgjithshme e mirëorganizuar në mbështetje të programit të studimit, e përbërë nga laboratorët, biblioteka;
5. Marrëdhënie të mirëstrukturuara dhe afatgjata me aktorë të interesit si rrjedhim i funksionimit të bordeve të tregut të punës, gjë që krijon mundësi për përshtatje me tregun e punës si dhe adaptim të shpejtë e fleksibilitetit sic është nevoja sot në industrinë e turizmit;
6. Marrëdhënie të ndërtuara në mënyrë sistematike me studentët, nëpërmjet zyrave të studentit, zyrave të karrierës, mentorëve që ndjekin progresin akademik dhe gjithashtu përdorimit të kahershëm të teknologjive digjitale në mbështetje të procesit të mësimdhënies;
7. Ofrimi në program i studentëve që kanë një përvojë ose dëshirojnë patjetër të kenë një përvojë direkt në fushën e turizmit;

**b. Pika të dobta:**


1. Programi DPT ka një qasje të fortë drejt lëndëve dhe elementeve brenda syllabuseve drejt lëndëve teorike dhe një filozofi të zbatimit praktik përmes rasteve studimore. Një qasje më praktike përmes metodave moderne si “të mësuarit përmes veprimt”, Vizitat, përdorimi i laboratorëve etj mungojnë ose janë në nivele të ulëta;
2. Mungesë e infrastrukturës specifike brenda laboratorëve e lidhur me degën e turizmit, infrastruktura hardware dhe software, pra mund të themi se ka laboratorë të përgjithshëm, por këtu mungojnë disa mjedise laboratorike specifike për Turizmin, të

cilët do të garantonin më mirë aspekte të mësimdhënies në nivel profesional, aplikativ dhe praktik;

3. Nevojë për një studim tregu më të detajuar të lidhur me kërkesën për specialist të këtij niveli profesional në ndërmarrjet turistike si dhe fokus i këtij studimi në aftësitë specifike që duhet të kenë studentët në përfundim të këtij programi, të kërkuara e të shprehura nga operatorët turistikë;
4. Mungesë e një numri të moduleve të lidhura specifikisht me turizmin, si Marketingu i Turizmit (nuk është njësoj me Baza marketing, megjithëse thuhet që shembujt janë për turizmin), Destinacionet turistike, Turizmi elektronik/digjital, Drejtim i ndërmarrjeve turistike, agjencive etj;
5. Mungesë e një literature të botuar në Shqip për lëndët (vetëm leksionet e parashkuara në Shqip nuk mjaftojnë për një diplomë të këtij niveli ku nevoja e studentëve është e madhe për të studiuar me libra në shqip);
6. Probleme me evidentimin e raporteve teori/praktikë në syllabuse dhe numër orësh mësimore që lidhen me praktikën konkrete për një specialist në sektorin e turizmit, psh specialist në agjencinë e udhëtimit, shërbimi i klientit/recepsioni në hotel, menaxhimi i sallave në restorante, specialist për ushqimin dhe pijen, organizimi i eventeve, katering etj;

## Rekomandime

1. Për të patur një qasje mbështetëse për ta bërë në mënyrë sa më cilësore këtë program GVJ sugjeron që jo vetëm të shtohen me shumë module dhe/ose lende që lidhen me turizmin, por edhe me shumë dije aftësi dhe njohuri të lidhura direkt me turizmin brenda lendeve të këtij programi, të shprehura në tema dhe jo vetëm në raste studimore;
2. Sygjerohet shtimi i programeve aplikative në laboratorët ekzistues për turizmin, tek InnoLab, vendosja e teknologjive si VR, të lidhura me turizmin, si dhe përshtatja e ndonjë prej hapësirave për laborator turizmi lidhur me operacionet dhe specialistët;
3. I sugjerohet departamentit se për shkak edhe të Pandemise COVID 19 edhe të ndryshimit të mënyrës së bërjes së biznesit, të rëndësishme se përfshirjes së teknologjive dhe ringritjes që po pëson edhe turizmi shqiptar, është e nevojshme që të reflektohet edhe në kërkime të mëtejshme që UET duhet të ndermarre jo vetëm për t'i paraprirë përmirësimit të kurrikules, por edhe nevojës për një edukim ndryshe mbarekombetar në turizmin shqiptar. Kështu rekomandohen kërkime me të thelluara të studime të tregut, që mundësisht të jenë studime të mirëfillta dhe sasiore, jo vetëm cilësore dhe me burim bordet e tregut të punës (si aktualisht janë bërë), të ndërmarra posaçërisht për diplomën DPT;
4. Në lidhje me marrëveshjet dhe kualifikimin profesional të stafit sugjerohet:





- orientimi i botimeve te tyre drejt industrise se turizmit jo vetem per shkak te perfshirjes se tyre aktive dhe direkte ne kete program studimi, por edhe per shkak te rendesise dhe rritjes qe po peson kjo industri turizmi per ekonomine shqiptare;
- Me shume mareveshje me institucione publike te lidhura me turizmin, por edhe me universitete apo IAL qe ofrojne programe te ngjashme studimi;
- 5. Çka sugjerohet lidhur me literaturën e përdorur, ne kete rast, eshte perdorimi i nje literature ne gjuhen shqipe jo vetem ato në ppt të përdorura nga lektori i lëndes por edhe nga autorë të tjerë, dhe/ose përkthime në gjuhën Shqipe. Gjithashtu sugjerohet qe ne lende apo module te formimit baze si statistike, matematike apo kontabilitet dhe informatike te perdoren literature me karakter aplikativ ne turizem. Psh statistika ne turizem, informatika ne turizem etj;
- 6. Sugjerohen me shume praktike mesimore brenda moduleve apo lendeve perkatese, psh ne lende bazike si matematike, statistike, kontabilitet si dhe gjithashtu lidhur me praktikën mësimore. GVJ sygjeron plotësimin dhe shumellojshmerine e metodave apo dhe kombinimeve te ndryshme. Shtrirja e praktikës vetëm në një semester në fund të studimit gjithashtu e përqendron vëmendjen në 4 semestra në teori dhe raste studimore, por një shtrirje ndryshe mund të ishte dhe një qasje diferencuese e diplomës profesionale. Kjo do perftonte me shume dije praktike dhe kompetenca profesionale;

## **Conclusions of the Evaluation of the study program with professional profile in "Tourism"**

### **a. Strengths and affirmations**

1. Well-organized structure of UET regarding the offering of DP tourism program, in terms of management and organization, rules, policies and structures of the department and faculty, institutional relations and support services, well-oriented job practices, all in function of existing programs , but also relatively new programs such as the GDT program;
2. The program creates opportunities to reach an important market such as the tourism market through future specialists, who graduate from an institution with experience as UET;
3. Experience of the academic staff of the department and consequently of the program, in teaching and research, which directly contributes to the creation of a quality offer for the program;
4. Generally well-organized infrastructure in support of the study program, consisting of laboratories, library, Information system etc;
5. Well-structured and long-term relationships with stakeholders because of the functioning of labor market boards, which created opportunities for adaptation to the

labor market and rapid adaptation and flexibility as needed today in the tourism industry;


6. Systematically built relationships with students, through student offices, career offices, mentors who follow academic progress and also the long-standing use of digital technologies in support of the teaching process;
7. Offering in the program students who have an experience or definitely want to have a direct experience in the field of tourism;

#### **b. Weaknesses**


1. The Professional program of Tourism Diploma has a strong approach to subjects and elements within the syllabi towards theoretical subjects and a philosophy of practical application mainly through case studies. A more practical approach through modern methods such as "learning by doing", Study visits, use of laboratories, etc. are missing or are at low levels;
2. Lack of specific infrastructure within the laboratories related to the field of tourism, specific tourism hardware and software infrastructure. There are general laboratories, but here are missing some specific laboratory facilities for Tourism, which would better guarantee aspects of teaching at professional, application and practical level;
3. Need for a more detailed market study related to the demand for specialists of this professional/specialist level in tourism enterprises and focus of this study on the specific skills that students must have at the end of this program, required and expressed by all companies operating in tourism industry;
4. Lack of a number of modules specifically related to tourism, such as Tourism Marketing (it is not the same as Fundamentals of Marketing, although it is said that the examples are for tourism), Tourist Destinations, Electronic / Digital Tourism, Management of tourism enterprises, agencies, etc;
5. Lack of a literature published in Albanian for the subjects (only the lectures in Albanian are not enough for a degree of this level where there is a strong need of students to study with books in Albanian);
6. Problems with evidencing theory / practice ratio in syllabi and number of teaching hours related to concrete practice for a specialist in the tourism sector, e.g. specialist in travel agency, customer service / hotel reception, restaurant/hall management, specialist for food and drink, organization of events, catering, etc;

#### **Recommendations:**

1. To have a supportive approach to make this program as high quality as possible, GVJ suggests that not only more modules and / or subjects related to tourism be added, but also more knowledge, skills and knowledge directly related to tourism. within the subjects of this program, expressed in topics and not only in case studies;



2. It is suggested to add application software in the existing laboratories for tourism, in InnoLab, the installation of technologies such as VR, related to tourism, as well as the adaptation of some Laboratory spaces, especially for tourism laboratory related to operations and specialists;
3. Due to the COVID 19 Pandemic, the change in the way of doing business and the importance of including technology for the undergoing recovery of Albanian tourism, it is necessary to reflect through further research to be undertaken in UET, not only the anticipation of curriculum improvements but also the need for a different concept of education in Albanian tourism. Thus, more in-depth research and market studies are recommended, which should possibly be genuine and quantitative studies (not only qualitative and through labor market boards, as actual market study), undertaken specifically for the this professional DPT degree;
4. Regarding the agreements and the professional qualification of the staff, it is suggested:
  - Orientation of their publications towards the tourism industry not only because of their active and direct involvement in this study program, but also because of the importance and growth that this tourism industry is experiencing for the Albanian economy;
  - More agreements with public institutions related to tourism, but also with universities or HEIs that offer similar study programs;
5. What is suggested regarding the used literature, in this case, is the use of a literature in Albanian language not only those in ppt used by the lecturer of the course but also by other authors, and / or translations in Albanian language. It is also suggested that specific literature, applied in tourism, to be used in subjects or modules of basic education such as statistics, mathematics or accounting and informatics. For example, statistics in tourism, informatics in tourism, etc;
6. Many teaching practices are suggested within the relevant modules or subjects, for example in basic subjects such as mathematics, statistics, accounting and related to teaching practice. GVJ suggests the complementarity and variety of different methods or combinations. Extending the internship to only one semester at the end of the study also focuses attention on 4 semesters in theory and case studies, but a different extension could also be a differentiating approach to the professional degree. This would provide more practical knowledge and professional competencies;



**Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit**

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përbushen	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT			X	
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT DHE MBËSHTETJA E STUDENTËVE			X	
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
<b>VLERËSIMI TËRËSOR</b>				<b>X</b>